BIJE SHI MBI FORMULA

Cili i burgosur politik kosovar, aq ogurzi, mund të besojë se mund t'i tarahitë koqet nëpër Kosovë duke bërë politikë e duke kontrabanduar mall antiamerikan nga Shqipëria?

Cili Salih i Shqipërisë salihe mund ta mashtrojë botën se si të hysh në NATO automatikisht do të hashë qull falas nga kazani i Eurounionit. Se si të hysh në NATO do t'i tarahitësh koqet nëpër bordelet e buta të Eurounionit duke trafikuar mall antiamerikan në Kosovë?

Cili Millosh i Serbisë milloshe mund të mos besojë se lufta i sosë fjalët, i sosë pazaret e Hagës?

Kontrabandistët ballkanas të mallit antiamerikan gabojnë kur mendojnë se edhe njëfarë ishkomunisti spanjoll, i quajtur Havier Solana, dikur paskësh bërë pazar me Eurounionin sipas Formulës së bankrotuar [P = + 1t – 1t – Nt] të Dolores Ibarurit.

Për të bërë pazar me tyxharin Havier të Eurounionit duhet dërguar në Bruksel Njeriun e liçencuar sipas standardeve të Formulës profitabile [P = Nt + 1t – 1t]

A s'ju duket mjaft?

Shqipëriasit e sotëm, të vetëshpallur “disidentë”, me çmime kineze, krejt sipas Formulës së bankrotuar, blejnë varre për vetjet e tyre në fund të detit të huaj, në fund të tokës së huaj, në fund të shtetit të huaj, në fund të atdheut të huaj.

Mbi varrin e “disidentit” shqipërias te varrezat e Moskës shkruan:

“Nitkov”!

Mbi varrin e disidentit” shqipërias te varrezat e Stambollit shkruan:

“Estokf’llah”!

Mbi varrin e “disidentit” shqipërias te varrezat e Vjenës shkruan:

“Volf”!

Në secilin nga këto varre, veçeveç, shkruan:

“Këtij varri i ka tepruar zoti, i ka tepruar profeti, i ka tepruar tempulli, i ka tepruar feja, i ka tepruar atdheu, i ka tepruar libri, i ka tepruar gjuha!”

Në të njëjtën kohë shqipëriasve u paskan munguar të gjitha: zoti, profeti, tempulli, feja, atdheu, libri, gjuha?! Si mund të teprojë dhe të mungojë e njëjta gjë në të njëjtën kohë?!

Edhe më keq! Shqipëriasve iu ka munguar Formula e kodit civil dhe e kodit biologjik [P= Nt + 1t – 1t].

Atëherë! Me cilën formulë janë shërbyer shqipëriasit prej Skënderbeut e deri te koha e sotme?!

Janë shërbye me Formulën e bankrotuar [P= + 1t – 1t – Nt]. Kësaj formuleje i teprojnë të gjitha dhe i mungojnë të gjitha në të njëjtën kohë!

Mungesën e kodit civil dhe të kodit biologjik e ka hetuar Dhimitër Shuteriqi.

Pse nuk foli?

Sepse u frikësua. Po Dhimitër Shuteriqi foli nga varri i vet nëpërmes shkrimtarit të Shqipërisë zyrtare, Ben Blushit, tek pergamenanroman “Të jetosh në ishull”.

Ben Blushit i ra hise të bëhët shqipëriasi i parë i Shqipërisë zyrtare në Diakroni e në sinkroni që Euroamerikës ia zbuloi Prototipin ekobiologjik të Shqipërisë zyrtare, të kodifikuar brenda Formulës funksionale të kodit civil e të kodit biologjik [P=Nt +1t – lt]. Kjo formulë funksionoi në Trekëndëshin e Logosit Euromerikan. Pa këtë Formulë të kodit civil e të kodit biologjik, te institucionalizuar, Shqipëria zyrtare kurrë nuk do të funksionojë. Do të mbetet shtet sakat, me të gjithë shtetasit e shtetarët sakatë, me zotin sakat, me profetë sakat, me religjione sakate, me tempuj sakatë, me gjuhë sakate, me libër sakat...

Derisa Shqipëria zyrtare të llaskucojë brenda formulës sakate [P=+ 1t – 1t – Nt] për jetë të jetës do të mbetet jasht Eurounionit, jashtë Euroamerikës.

Dora e qashtër e Dhimitër Shuteriqit, nga varri i vet i thellë, nëpërmes kumtit të Ben Blushit, shqipëriasve të vet ua kumtoi Megaformulën e tipit hebre të Rabi Jochanan ben Sakait [P=Nt + 1t – 1t].

Prototipi i Ben Blushit, me emrin e përkohëshëm Ibrahim, tek Pergamenaroman "Të jetosh në ishull", për herë të parë në të gjitha letrat e në të gjithë historinë e Shqipërisë zyrtare, e arrin Megaformulën e hebreut Rabi Jochanan ben Sakait. E ta arrish sot efektin e Megaformulës hebreje para Selisë së Brukselit të Eurounionit do të thotë krejtësisht tjetër nga se ç'kanë menduar shtetarët së bashku, qe nga ai Skënderbeu e deri tek salihët e sotëm.

Do të thotë ta mendosh atë ç'e ka mendua Ben Gurioni i Izraelit në vitin 1948.

Hiç më shumë as më pak.

Kaq shumë mund të bëjë një libër !?

Po! Kaq shumë mund të bëjë një libër !

A do të pajtohen shtetarët e Shqipërisë së sotme me denoncimin e Prototipit të Ben Blushit para Selisë së Brukselit?

Jo!Nuk do të pajtohen.

Atëherë do ta shpallin tradhtar këtë burrë të shekullit XVIII.

Mbase edhe më keq.

Për ta shpallur tradhtar Prototipin e "Ishullit"të Ben Blushit del punë me shumë qeder. Prototipi i Ben Blushit, me emrin e përkohëshëm Ibrahim del i vetmi burrë i blinduar në të gjitha letrat e Shqipërisë zyrtare qe prej fillimit e deri në vitin 2008. Kulturologët e Shqipërisë zyrtare nuk mund të flasin as mirë as keq për këtë Prototip të blinduar brenda Formulës se kodit civil e të kodit biologjik[P= Nt + 1t – 1t].

Vetëm e shikojnë vëngër.

Pse kaq i blinduar, kaq i paprekshëm, ky Prototipi Ibrahim i Ben Blushit!?

Askush nga kulturologët e Shqipërisë zyrtare nuk mund të thotë se bëri mirë fshatari, me emër të përkohëshëm Ibrahim që e ndërroi fenë por askush nuk mund të thotë se bëri keq kur e ndërroi fenë. Fjalët Mirë e Keq, për këtë rast, do ta lëndonin bashkimvëllazërimin ndërfetar të shqipëriasve. E, megjithatë fshatari Ibrahim vazhdon, krejt në qetësi, të blejë e të shesë religjion aqsa i nevojitet për konsumin e familjes së vet biologjike.

Meqë kulturologët shqipërias, të krishterë e myslimanë, nuk mund t'ia thonë troç Ben Blushit, atëherë provojnë t'ia thonë tërthorazi, nëpërmes hebreut të bankrotuar, nëpërmes Sabatai Sevit, i cili i këmbei religjionet ashtu kuturu. Por ky Sabatai Sevi jep kumte të dyshimta si për Prototipin Ibrahim të Blushit, si për shqipëriasit tjerë, qoftë me jetën e vet, qoftë me fetë e veta, qoftë me dy varret e veta –njërin në Berat e tjetrin në Ulqin. Ngado që ta shqyrtojmë, Sabatai Sevi mbetet brenda formulës së bankrotuar [P=+ 1t – 1t – Nt].

Kulturologët shqipërias kur e shpallin Sabatai Sevin diversant brenda fesë myslimane tërthorazi e qortojnë Ibrahimin e Ben Blushit. Të tjerët, duke u përpjekur të duken sa më indiferent ndaj aktit të Sabatai Sevit, e miratojnë tërthorazi Ibrahimin e Ben Blushit.

Një katundar si Ibrahimi i Ben Blushit nuk mund të mëtohet kaq tepër.

Kur Sabatai Sevi konvertohet prej fesë hebreje në fenë myslimane mëtohet se bën politikë diversantësh. Kur konvertohet Ibrahimi i Ben Blushit nga feja e krishterë në fenë myslimane metohët se bën mëkat ose sevap.

Këtu ngatërrohen formulat.

Formula e Sabatai Sevit na tregon se ky hebre nuk shet religjion as nuk blen religjion. Sabatai Sevin e blen religjioni dhe e shet religjioni. Krejt ngjashëm me shqipëriasit e Shqipërisë zyrtare, Sabatai Sevit në të njejtën kohë i teprojnë të gjitha dhe i mungojnë të gjithat: feja, profeti, tempulli, morali, gjuha, libri...

I teprojnë dhe i mungojnë të gjitha entitetet e Izraelit. Bile i teprojnë dhe i mungojnë të dy varret e veta – njëri në Berat e tjetri në Ulqin.

Përkundër këtyre mëtesave krahasuese me hebreun Sabatai Sevi, Prototipi i Ben Blushit, përkohësisht i quajtur Ibrahim, e vazhdon tregtinë katundare të shitblerjes së profetëve, të tempujve, të religjioneve, të emrave, të grave.

Po kush është ky Ibrahimi i pergamenës së Ben Blushit"Të jetosh në ishull"?

Është Prototipi i parë në të gjitha letrat e Shqipërisë zyrtare, qe prej fillimit e deri sot, i cili i bie ndesh cenzurës së patriotizmit të falsifikuar të bashkimvëllazërimit fetar të shqipëriasve.

Po ç'do të thotë ta theshë cenzurën e patriotizmit të falsifikuar të bashkimvëllazërimit fetar të shqipëriasve?

Do të thotë ta pranosh se je i vocërr në konfliktin ndërfetar midis Europës e Azisë.

Po a kanë kaçik shqipëriasit e Shqipërisë shtetërore ta kapërcejnë këtë konflikt ndërkontinental midis Europës e Azisë?

Si të doni!

Sikur të mos e kapërcejnë shqipëriasit e Shqipërisë zyrtare këtë konflikt ndërfetar midis Azisë dhe Europës, do të mbesin të përballur armiqësisht të krishterët shqipërias e myslimanët shqipërias.

Shqipëriasit e Shqipërisë zyrtare nuk kanë koqe të vejnë cenzurë mbi konfliktin fetar euroaziatik duke çpikur religjion të ri prej bektashinjsh.

Atëherë shqipëriasit qenkan bllokuar para situatës së pazgjidhje!?

Po nuk e ndërruan Formulën do të mbesin të ngërthyer.

Qe nga Skëndebeu e deri tek Salihu i sotëm, gjithmonë shqipëriasve u kanë munguar njësitë matëse.

I kanë matur kuturu të gjitha: religjionin, patriotizmin, moralin, trimëritë, gjuhën, librin, atdheun, polititikën.

Shqipëriasit kanë bërë pazar sipas formulës së bankrotuar[P=+ 1t – 1t – Nt]. Pikërisht për këtë kanë dalë humbës gjithmonë.

Për herë të parë në letrat e Shqipërisë shtetërore, Prototipi, i quajtur përkohësisht Ibrahim, i Ben Blushit, te libri "Të jetosh në Ishull" e kapi Formulën [P= + Nt + 1t – 1t].

Ibrahimi i Ben Blushit, tek libri "Të jetosh në ishull" për herë të parë në Shqipërinë shtetërorë bën pazar sipas Formulës profitabile [P= Nt + 1t – 1t].

A ka ndodhur vërtetë Prototipi Ibrahim i Ben Blushit?

Jo! Ende!

Prototipi, i Ben Blushit, me emër të përkohshëm, Ibrahim duhet të ndodh si projekt kodifikimi në Shqipërinë shtetërore.

Kjo Shqipëri shtetërore mëtohet t'i shikojë drejt në sy dy kodifikimet më të spikatura botërore sipas Formulës [P= Nt + 1t – 1t] – njërën në Jerusalem e tjetrën në Masaçusets.

Në librin pergamenë me titull "Pocahontas Powhatan", të financuar sivjet nga ABF-i në Treleborg të Suedisë, në një variant tjetër nga "Të jetosh në ishull",ipet Megaformula e kodifikuar hebreje dhe Formula e kodifikimit amerikan.

Natën e tretë të shtatorit të vitit 70 të Jezusit, në tubimin e rabinëve të Jerusalemit u përplasën midis tyre të dy formulat hebreje.

Kur rabinët e Jerusalemit u lugatësën në ”Hosana Baraba!” përmes Formulës [P=+ 1t – 1t – Nt], rektori i të dy universiteteve të Izraelit, Rabi Jochanan Ben Sakai, i kundërshtoi rabinët radikalë.

Rabi ben Sakai e kundërshtoi luftën e Izraelit kundër Romës imperiale.

Po atë natë e shpallën tradhtar.

Ky rabii tok me 30 studentët e vet të Sanhredinit, të ngarkuar me librat e të dy bibliotekave të Izraelit, u arratis nga Jerusalemi drejt Diasporës evropiane nëpërmes formulës Megahebreje: [P=Nt + 1t – 1t] për t’u kthye në Izrael me avionë reaktivë euroamerikanë rrafsh pas 1878 vjetësh.

Rabinët e Jerusalemit të formulës së bankrotuar [P=+ 1t – 1t – Nt], të lugatosur në “Hosana Baraba!”,vendosën të hyjnë në luftë, skajsmërisht të pabarabartë, kundër Romës perandorake. Të nesërmen Roma perandorake e bëri Jerusalemin rrafsh me tokë. Rabinët e formulës sakate e humbën Jerusalemin, e humbën Izraelin.

Rabi Jochanan ben Sakai, i Megaformulës hebreje, me ndihmën euroamerikane e shpëtoi Jerusalemin, e shpëtoi Izraelin.

Po çka ndodhi mbrëmjen e njëzetegjashtë të janarit në Masaçusetsin e vitit 1621?

Këtë natë angloirlandezi, John Harker, e zuri fillin e korrigjimit të Formulës evropiane përmes Formulës indigjene të Pokahontas Powhatanit.

Po kush do ta ruante Megaformulën e kodifikuar të Shqipërisë siç bëri Jochanan ben Sakai më Megaformulën e Izraelit, siç bëri John Harkeri me Megaformulën amerikane?

Askush tjetër përveçse Prototipi, me emer të përkohshëm Ibrahim,i Ben Blushit, i emigruar në “Ishull”.

Këtë punë, të ngjashme me hebreun ben Sakai, ka qenë deshur ta bëjnë për Shqipërinë zyrtare: Marin Barleti, Marin Beçikemi, Anonimi i Tivar-it...Por këta burra, sipas formulës së bankrotuar [P=+1t – 1t – Nt], e humbën Shqipërinë.

Le ta supozojmë vetëm ditën e tretë të marsit të vitit 1479, si ditë të saktë eksperimentalisht, për të dy formulat shqiptare por jo krejt të saktë historikisht.

Pas tri vjetësh rrethimi të Shkodrës, shkodranët u detyruan t’iu dorëzohen autoriteteve turke.

Evrenoz pasha, po këtë ditë, ua mësoi shkodranëve udhën për kapërcimin e detit. Pashai turk urdhëroi të hapen dyert e qytetit. I urdhëroi shkodranët të mos e kthejnë kokën djathtas as majtas, të ecin drej detit, drejt Italisë.

Këtë ditë të tretë të marsit Marin Barleti i kishte 20 vjet, Marin Beçikemi i kishte 46 vjet.

Këtë ditë të tretë të marsit të vitit 1479 athua kishte ndonjë libër të gjuhës së Marin Barletit në qytetin e Shkodrës, siç supozojmë sot ne?

Nëse kishte në Shkodër libër të gjuhës së Barletit – shumë keq!

Nëse nuk kishte në Shkodër libër të gjuhës së Barletit – edhe më keq!

Në të dy rastet, Marin Barletit i tepruan atë ditë: atdheu, feja, morali, gjuha, libri, profetët, tempujt...

Asnjërit nga këta burra nuk ua mbajti ta marrin me vete një libër të gjuhës së Skënderbeut – vetëm një të vetmin libër, nëse ky libër paska ekzistuar, për ta nxjerrë në Itali si dokument për brezat e ardhshëm!

Ditën e tretë të marsit të vitit 1479 Marin Barletit i teproi libri, atdheu, religjioni, i teproi frika !

Një libër të gjuhës së Skënderbeut nuk e nxori në Itali asnjeri nga familja e kastriotëve!

Po të ishte nxjerrë në Itali një libër shqip, siç pretëndojmë ne sot se kishte, atëherë shqipëriasit qyqarë të Shqipërisë zyrtare do ta fillonin shumë më herët studimin për dokumentet e gjuhës s vet e, jo të nisen nga ajo Formula e pëshurrtë e pagëzimit!

Marin Barleti na provokon të pyesim: çka do të kishte bërë në këtë ditë të tretë të marsit të vitit 1479 rabi Jochanan ben Sakai i Megaformulës hebreje?

Shqipëriasi i sotëm do ta ngushëllojë veten duke konstatuar se Papës italian i pëlqente, atëherë e sot, shpata e Skënderbeut por e urrente librin e Skënderbeut. Papa italian, atëherë e sot,e paska dashur luftën e Skënderbeut e jo gjuhën e Skënderbeut. Në fund edhe mund të thuhet se Papa italian paska deshur që shqipëriasit ta njohin gjuhën e vet, për të parën herë, në atëfarë Formulën e stërkequr të pagëzimit!

Po pse të mos e ngushëllojë vetveten shqipëriasi i sotëm se do ta kenë kapërcyer detin drejt Italisë librat e Skënderbeut por Papa italian i paska pasë zhdukur. Pastaj të shtojë se kështu veproi armiku shekullor i shqiptarëve.

Ngushëllim i falsifikuar, i mjaftueshëm për ngushëllimin e të ligut!

Me të emigruar në Itali, Marin Barleti e shkroi librin me titull maratonik për Skënderbeun.

Marin Barletit në këtë libër shkroi për shpatën dhe për luftën e Skënderbeut por nuk shkroi për gjuhën dhe librin e Skënderbeut. Edhe te ky libër Marin Barletit i tepruan të gjitha: atdheu, feja, libri, gjuha, morali, profeti, tempulli.

Për të satën herë Marin Barleti na provokon të pyesim se çka do të kishte bërë Rektori i dy universiteteve të Izraelit, Hebreu Rabi Jochanan ben Sakai ditën e tretë të marsit të Shkodrës ?

* * *

Shqiptarët e Marin Barletit kanë lektisur ta shkruajnë librin e kodit historik, librin e gjenetikes, brenda asaj Formulës së bankrotuar të pagëzimit. Po kjo Formulë e pagëzimit, si mjaft e krishterë, a mund t'i premtojë Shqipërisë vend në Eurounion?

Jo!

Po Shqipëria shtetërore ka hall ekzistencial.

Shqipëria shtetërore paska ngecur brenda Formulës së bankrotuar të historicizmit sakat, të zotit sakat, të religjionit sakat, të tempullit sakat, të librit sakat, të gjuhës sakate...

Shqipëriasit duke aktruar historicizëm me krishterimin e varfër të Formulës së Pagëzimit të Skënderbeut, menduan ta përdorin si dokumente të vlefshme për të hyrë në Eurounion.

Prijatarët e sotëm të Shqipërisë shtetërore, në pikë të ditës së zotit, çjerrën deri në kupë të qiellit:"Shqipëria po hyn në Eurounion"!

Por tyxhari Eurounionit na i paska parametrat tjerë të civilizimit, ndryshe nga ç'i mendojnë arixhinjt e politikës së Shqipërisë.

Për të hyrë në Eurounion, ai tyxhari i Brukselit po ia kërkuaka një paradigmë identitetesh Shqipërisë zyrtare, një letërnjoftim më shumë se ç'thotë Formula e hajthme pagëzimit apo Skënderbeu i dyshimtë.

Tyxhari i Brukselit po ia kërkuaka Shqipërisë shtetërore këto identitete te paradigmës së civilizimit në diakroni dhe në sinkroni: zotin e vet, profetin e vet, religjionin e vet, tempullin e vet, gjuhën e vet, librin e vet, trollin e vet, shtetin e vet, pushtetin e vet...

Europa sillet në mënyrë kaq qortuese ndaj shteteve të pa këtë paradigmë të civilizimit sepse edhe vetë Europës, në korrespondim me Amerikën, i mungojnë dy kohët gramatikore te kodit civil e biologjik.

Pas përpjekjeve dëshpëruese të shqipëriasve për të trokitur në dyert e Brukselit me krishterimin e varfër të Formulës së pagëzimit e të Skënderbeut,

në letërsinë e Shqipërisë shtetërore u shfaq kyfarë Ben Blushi me Pergamenën "Të jetosh në ishull".

Për herë të parë në letërsinë e Shqipërisë zyrtare, tek libri i Ben Blushit, u fol ndryshe nga ç'folën: Formula e varfër e pagëzimit, Skënderbeu, Avdyl Frashëri, Ismail Qemali, Fan Noli, Ahmet Zogu, Enver Hoxha apo, ndryshe seç flasin salihët e sotëm të Shqipërisë zyrtare.

Edhe pse në librin e Ben Blushit "Të jetosh në ishull" shihet dora e qashtër e Dhimitër Shuteriqit në njërën anë dhe realizmi magjik i Markesit në anën tjetër, prototipi ekobiologjik, për herë të parë, zë të funksionojë në letërsinë e Shqipërisë zyrtare.

Në Shqipërinë shtetërore libri i Ben Blushit "Të jetosh në ishull" shkaktoi konflikt të çpifur midis të krishterëve e myslimanëve. Myslimanët sakatë dhe të krishterët sakatë, si çdo gjë në Shqipërinë sakate, e çpifën konfliktin ndërfetar, të nxitur nga libri i Ben Blushit "Të jetosh në ishull".Të krishterët e Shqipërisë shtetërore e aktruan të fyerin e, myslimanët e aktruan fyesin.

Lektisja e shqipëriasve të Shqipërisë zyrtare për ta çpifur një konflikt ndërfetar ngjanë në perverzitet psikiatrik. Shqipëria shtetërore nuk ka kaçik as koqe për të shkaktuar konflikt ndërfetar apo ideologjik. Konflikt ndërfetar e ideologjik mund të shkaktojnë kontinentet. Poashtu Shqipëria shtetërore nuk ka kaçik as koqe të bëjë renovime fetare e ideologjike të llojit bektashian e sockomunist.

Haxhi Bektashi, i hipur mbi pelën shiite të Abaz Aliut, u shpalli luftë qendrave të revizionizmit mysliman si: Qabes, Mekës, Medinës, e pastaj u arratis në Shqipëri. Enver Hoxha, hipur mbi Rosinantin e vet ideologjik, me koqe prej Don Kishoti, në mënyrë regulare e singulare, u shpalli luftë qendrave marksisteleniniste evroaziatike si: Beogradit, Moskës, Pekinit.

Shqipëria shtetërore do të mbetet në amokun e viteve të mbrapshta ose, si po na pëlqen t'i quajmë këto vite: "Times of comet" përderisa të ngërthehet në pezhishkën e Formulës së bankrotuar[P=+1t – 1t – Nt].

Por!

Ndodhi rebelimi në kodin biologjik e civil të Shqipërisë zyrtare nëpërmes pergamenës së Ben Blushit "Të jetosh në ishull".

U rebelua fshatari i shekullit të XVIII, fshatari me emër të përkohëshëm Ibrahim.

Ibrahimi i Ben Blushit ndryshoi nga Kostantini i Formulës së bankrotuar të besës së pëshurrtë patriotike të shqipëriasve që ngritet nga varri e shkon në Eurounion për ta marrë motrën Doruntinë. Nuk ishte ai Kostantini pizeveng që i mashtroi motrën e nënën.

Por!

Është fshatari i rebeluar i Ben Blushit, me emër të përkohshëm Ibrahim, i cili shkon para selisë së Brukselit për ta denoncuar Shqipërinë shtetërore.

Po cili është denoncimi i fshatarit Ibrahim të Ben Blushit para selisë së Brukselit?

Për herë të parë në historinë e Shqipërisë zyrtare Ibrahimi i Ben Blushit e kundërshton formulën e bankrotuar [P=+1t – 1t – Nt].

Ibrahimi i Ben Blushit i mohon karaxhozllëqet e lojës së Isa Boletinit me pistoleta atje në Londrën e tyxharllëkut diplomatik. Fshatari prototip i Ben Blushit ia jep kumtin Eurounionit se Shqipëria shtetërore mund ta kapë kodin biologjik e civil të Formulës [P=+Nt + 1t – 1t].

Jo vetëm kaq!

Ky burrë i rebeluar i Blushit duke e promovuar Formulën e kodit biologjik e civil të Shqipërisë shtetërore, ia mëson Eurounionit se ku duhet gërmuar në rrënojat biologjike të Shqipërisë shtetërore për ta nxjerrë nga atje eksponatin e prototipit biologjik.

Jo vetëm kaq!

Eurounioni duke gërmuar në rrënojat biologjike të Shqipërisë shtetërore, po edhe të shteteve të tjera ishsocialiste, do të mësojë diçka për retardimin shëndetsor edhe të vetjes së vet Eurounionit.

Jo vetëm kaq!

Do të mësojë se vetë Eurounionit, në korrespondim me SHBA-të, i mungojnë dy kohë të gramatikës biosociale.

A s'ju duket mjaft !?

* * *

Libripergamenë i Ben Blushit "Të jetosh në ishull" u shit në pikë të ditës!

Lexuesit shqipërias i ra tesëll!

Fjalia e parë e librit, dita e parë e librit, protagonisti i parë i librit, erdhen të blinduar.

Për herë të parë lexuesit shqipërias nuk i funksionoi formula e bankrotuar [P=+1t – 1t – Nt].

Ç'do të thotë të mos funksionojë Formula e bankrotuar?

Do të thotë krejt.

Për herë të parë shqipëriasit e panë se u kishin tepruar: zotërat, profetët, tempujt, fetë, morali, gjuha, atdheu, libri, heroizmi, historia, vitet e mbrapshta, po edhe qielli i "Time of comet".

Për herë të parë shqipëriasit e panë se u kishte tepruar vetvetja.

Për herë të parë shqipëriasit e Shqipërisë zyrtare u gjenden para dyerve të Formulës [P=Nt + 1t – 1t].

Për herë të parë shqipëriasit e panë se me Eurounionin pazari bëhët sipas masave të Formulës [P=Nt + 1t – 1t].

Pazar i vështirë !

Sipas kësaj Formule si do të shkojë në Londër Isa Boletini?!

Sipas kësaj Formule si do të dalë në teatrin e Vraninës Oso Kuka?!

Sipas kësaj formule si do të mbahej Lidhja aq panshqiptare e Prizrenit në pikë të ditës së qershorit pa e penguar askush, sikur Turqia të kishte vdekur!

Sipas kësaj Formule si do të bëhej historia!

Pazar i vështirë !

* * *

Në librin pergamenë të Blushit "Të jetosh në ishull", me "dyqind vjet vetmi" të kodit gjenetik të Garsia Marquesit, rrugëtohet sipas renditjes: familja e fshatarit Ibrahim, fshati i Ibrahimit, Voskopoja, Suli, Janina, Selaniku, Kreta, Stambolli.

Rrugë e gjatë për kodin gjenetik të një populli !

Fjalia e parë e librit "Të jetosh në ishull"do t'i shkonte çdo libri të Marquesit, çdo feje të Ballkanit hardall:

"Atë ditë në fshat nuk hahej mish".

Mbase do të ketë qenë ditë agjerimi për myslimanët dhe të krishterët.

Po këtë ditë agjerimi, për të gjitha fetë, një fshatar i krishterë kalon prej fesë ortodokse ne Islam.

Ky fshatar, po këtë ditë, bëhet Ibrahim i përkohëshëm.

Edhe pas kësaj dite, në familjen e fshatarit Ibrahim zotat, profetët, religjionet, tempujt, vazhdojnë të rrinë cuc nën peshën e biologjizmit të familjes tok me lopët, me delet, me kuajt e Ibrahimit sipas formulës biologjike të një fshatari.

Nuk u ipet çmim më i lartë se një deleje.

Shqipëriasit e Ben Blushit, atëherë dhe sot e gjithë ditën e lumë të zotit, nuk kishin kaçik t'i pajtonin midis tyre profetët e shkretëtirës dhe profetët e Europës sipas formulës së bankrotuar të Ali Tepelenës.

Fshatari Ibrahim shet e blen religjion vetëm aqsa konsumon familja.

Ali Tepelena shitet e blehet nga religjioni aqsa konsumon Perandoria turke.

Këtu shpalosen për herë të parë dy formulat krejt të ndryshme.

Fshatari Ibrahim shet e blen religjion sipas Formulës [P=Nt + 1t – 1t].

Ali Tepelena shitet e blihet sipas Formulës [P=+ 1t – 1t – Nt.

Fshatarit Ibrahim nuk i tepron religjioni. Ai blen religjion aqsa i nevojitet për nevojat shtëpiake.

Ali Tepelenës i tepron religjioni. Ai shitet e blihet nga religjioni perandorak.

Në fund të këtyre pazareve Ben Blushi i shqyrton të gjitha matjet për ta bërë një Shqipëri ishullore, të mos e kollofisin profetët e uritur.

E shqyrton bërjen e një Shqipërie të llojit skënderbeg.

E shqyrton bërjen e një Shqipërie bektashiane.

E shqyrton bërjen e Shqipërisë sockomuniste.

Ishullin Shqipëri duhet ta bëjë dikush.

Duhet ta bëjë një lider.

Kush tjetër mund ta bëjë këtë Shqipëri ishullore përveçse Enver Hoxha?

Kështu edhe duhej të ishte. Politika e Enver Hoxhës ishte në anën e fshatarit.

Në fillim u mendua se politika sociale e Enver Hoxhës do të konsumojë religjion e ideologji sipas Formulës së ekonomisë biologjike [P=Nt + 1t – 1t].

Sa për politikat nacionaliste të Ballit e të Legalitetit, e simotrave të tyre, dihej. Në programet e tyre këto parti e kishin shpallur kryefjalë Formulën e bankrotuar [P=+ 1t – 1t – Nt].

Tyxhari i Eurounionit i njihte mirë të dy formulat, shumë kohë para të dy luftërave botërore.

Prandaj historianët e djeshëm po, edhe këta të sotmit, i kanë koqet e prera për të bërë histori sipas Formulës së bankrotuar. Në shkrimet e tyre eunuke bëlbëzohet diçka eunukisht kundër shkarjeve të Euroamerikës fill pas Luftës së dytë.

Euroamerika duke e shqyrtua Formulën e bankrotuar të partive nacionalfolklorike të Ballit e të Legalitetit u shmang sosh.

Nuk vonoi shumë e Enver Hoxha e nisi me programin e vet krejt sipas Formulës së bankrotuar.

Bilansi i programeve politike të Shqipërisë u përmbyll në Formulën e bankrotuar për të gjithë shtetarët deri tëk salihët e sotëm.

Shqipëria shtetërore u përmbyll përfundimisht në këtë Formulë të bankrotuar tok me të gjitha shtetet sockomuniste të paktit të Varshaës.

* * *

Pasi kulmi i Kremlinit zu të pikojë nga të gjitha anët qe në fund të viteve të tetëdhjeta të shekullit XX, shtetet e Paktit të Varshavës zunë t'i shpallin vetjet e tyre dofarë disidentësh.

Në fund të radhes së këtyre shteteve, të vetëquajtura disidente, u zu edhe Shqipëria zyrtare.

Kjo Shqipëri zyrtare, pasi i kishte provuar të gjitha pazaret e arixhinjve ideologjikë të Euroazisë, zu t'i bije ndërmend Eurounioni.

Por Shqipëria shtetërore edhe për tyxharin Eurounion e kishte vetëm Formulën e bankrotuar biologjikisht.

Qe në fillim pazari i Shqipërisë me tyxharin eurounion ngeci.

Ky tyxhari eurounionas parashtroi kusht për kontratë me Shqipërinë zyrtare.

Cili shqipërias, nga këta pushtetarët e sotëm, mund të bëjë kontratë me Eurounionin?

Asnjeri !

Dreqopunë!

NATO është tyxhar tokash, jo tyxhar i kodeve civile e biologjike.

Në këtë tregti tokash Eurounioni mund ta përseritë gabimin e Austrisë së vitit 1912.

Cili qe gabimi i Austrisë së vitit 1912?

Ausrtria e vitit 1912 e bëri një Shqipëri maskotë por kurrsesi një Shqipëri me kod civil e biologjik.

Një vit më vonë, në vitin 1913, në qiellin e Shqipërisë austriake u shfaq kometa e amokut.

Austria e vitit 1912 e bëri një Shqipëri përngutazi, sa për sy e faqe - aqsa i duhej për ta penguar detin e lakmuar nga Serborusia.

Austria e vitit 1912 kurrë nuk patë kohë të merret me shtetasit maskota të kësaj Shqipërie maskotë.

Prandaj Eurounioni duhet të tregohet tyxhar më i shkathët se Austria e vitit të kometës.

Duhet ta blejë tokën dhe shtetasit.

T'i lëshë shtetasit të sorollatën në Formulën e bankrotuar ka rrezik të bëjnë diversion brenda shtetit të vet.

Prandaj Eurounioni duhet ta zbulojë prototipin e shqipëriasit të Formulës [P=Nt + 1t – 1t] me të cilin do të bëjë kontrata shtetërore.

Po në cilën nyje të diakronisë do ta gjejë Eurounioni këtë prototip shqipërias?

Eurounioni u desh të gërmojë, retrospektivisht, dy shekuj më heret në rrënojat biologjike të Shqipërisë shtetërore. Atje, në shekullin XVIII, Eurounioni do ta zë fillin evolutiv të kodit biologjik të shqipëriasve.

Eurounioni gjatë gërmimeve në rrënojat biologjike të Shqipërisë zyrtare do ta përdorë metodën e Bretkosës së Darvinit.

Cila është metoda e Bretkosës së Darvinit?

Bretkosa e Darvinit, sipas Formulës [P = Nt + 1t – 1t] i jep të gjitha informatat e llojit të vet.

* * *

Të jetuarit në Ishull Ben Blushi e merr nga përvoja.

Më në fund Ben Blushi, për herë të parë në letrat e Shqipërisë zyrtare, e arrin realizimin e Prototipit sipas formulës më të saktë të Bretkosës së Darvinit [P=Nt + 1t – 1t] jo vetëm në letërsi por edhe në histori, në filozofi, sociologji, politikë...e deri te kodifikimi gjenetik.

Po kush është Prototipi?

Prototipi, si në të gjitha shkencat e arrira, i jep saktësisht të gjitha të dhënat për llojin e vet.

Sipas kësaj formule bën shkencë Darvini.

Çarls Darvini eksperimenton sipas Formulës [P= Nt + lt – 1t].

Darvini e merr vetëm një bretkocë nga këneta, vetëm një ekzemplar. E shpie në laborator për ta studiuar. E copton pjesë-pjesë për ta studiuara analitikisht ndërtimin organik të Bretkosës Prototipe.

Sipas studimit shkencor të Darvinit një bretkosë prototipe i jep të gjitha informatat e llojit të vet prej bretkose.

Çarls Darvini e vret një bretkosë të vetme për t'i shpëtuar të gjitha bretkosat tjera të kënetës.

Bretkosa e Darvinit flijohet. Bëhet prototip.Vetëm në tretmanin e prototipit Bretkosa e Darvinit i jep informatat e sakta të llojit të vet.

Edhe në lëmenjt tjerë u desh të përdoret metoda e tillë.

Por ndodhi ajo tjetra !

Jo vetëm në Shqipërinë zyrtare, por në të gjitha diktaturat ndodhi e kundërta e metodës shkencore.

U vranë të gjitha bretkosat për t' u shpëtuar vetëm një bretkosë!

U vranë të gjithë shtetasit për t'u shpëtuar vetëm një shtetas!

Në kënetën Shqipëri, pas molisjes së Kremlinit, ndodhi që bretkosat e vrara të "rebelohen" për ta vrarë Bretkosën diktatore.

Për pikë të ditës së zotit, shtetasit e kënetës Shqipëri, kolektivisht e shpallën vetjen e vet "disident" politik!

U "rebeluan"kundër Diktatorit të Shqipërisë politike.

E shpallen Enver Hoxhën të vetmin fajtor në Shqipërinë politike.

Mbrëmjen e njëzet të shkurtit të vitit 1991 Enver Hoxha shkoi në kryqin e Kalvarit për ta shpëtuar Shqipërinë e vet politike. Po këtë mbrëmje, Enver Hoxha zbriti nga piedestali për t'u ngre zvarrë nëpër sheshin e Tiranës. Enver Hoxha i mori mbi shpatullat e veta të gjitha mëkatet e Shqipërisë politike.

Shqipëriasit e Shqipërisë politike mbrëmjen e njëzet të shkurtit të vitit 1991, përmes teatrit golgotian, lektisën t'i tregojnë botës se sa "disidente" është Shqipëria politike.

Skena biblike e zbritjes së Enver Hoxhës nga piedestali, mbrëmjen e njëzet shkurtit të vitit 1991, Shqipërinë politike e nxori në ekranet e botës.

Edhe në funeralin e dytë të Enver Hoxhës Shqipëria nuk po mundej pa Enver Hoxhën.

Edhe në funeralin e dytë të tij Enver Hoxha ngadhnjeu mbi shqipëriasit e vet.

Shqipëriasit nuk munden pa Enver Hoxhën.

Çka ndodh dy herë ndodh përherë.

* * *

Shtetasit e Shqipërisë politike, sot e gjithë ditën e lume të zotit, gabojnë kur e "mohojnë" Prototipin Enver Hoxha. Këta shtetas, sot e gjithë ditën e zotit, krejt pabesueshëm, krejt ndërkyeshëm, kolektivisht, vetshpallën "disidentë"duke ia ngarkuar të gjitha mëkatet vetëm Enver Hoxhës.

Me këtë akt "disidence" shtetasit shqiptarë duan të arratisen nga lloji i vet.

Por Enver Hoxha e pranoi aktin e flijimit.

Enver Hoxha nuk e lejon arratisjen e shtetasve nga lloji i vet.

Enver Hoxha i njeh shtetasit e vet aqsa i njihte Darvini bretkosat e Kënetës së vet. Andaj, mbrëmjen e njëzet shkurtit të vitit 1991, Enver Hoxha e pranoi aktin e flijimit biblik në shkallë Prototipi duke i dhënë para ekraneve të botës, të gjitha informatat e sakta të llojit të vet shtetasve shqiptarë.

Një lexues shqipërias, po edhe shumë lexues, mbase edhe të gjithë lexuesit, shtetas të Shqipërisë zyrtare, mund të deklarojnë se në veprën e Ben Blushit ”Të jetosh në ishull”askund nuk përmendët Enver Hoxha decidivisht.

Le të jetë edhe ashtu.

Për një mendje analitike të nivelit angloirlandez del ndryshe.

Edhe pse Xhojsi askund brenda librit nuk e përmend Uliksin, të gjithë lexuesit angloirlandezë e pranojnë Prototipin e nëndheshëm të një korrespondimi me Uliksin e Homerit.

Libri i Xhojsit e ka një titull “Ulisi”.

Natyrisht se kishte vetëm një Uliks.

Poaq kishte vetëm një Enver Hoxhë.

Por, kush tjetër përveçse Enver Hoxha mund ta bëjë ishullin Shqipëri ?

Libri i Ben Blushit ka një titull “Të jetosh në ishull” ku të gjithë shtetasit do ta mësojnë notimin e jetës sipas cilës formulë do të bëhet?

Shqipërinë ishull ku të gjithë shqipëriasit e mësuan notimin e jetës e provoi Formula shterpë e sockomunizmit.

Këtë Golgotë të dështuar shqipëriasit ”disidentë” ia ngarkuan mbi shpatulla Enver Hoxhës mbrëmjen e njëzet shkurtit të vitit 1991.

* * *

Ibrahimi i Ben Blushit tek libri ”Të jetosh në ishull” e jep formulën e gatshme të kodit biologjik.

Këtë formulë deshi ta jetësojë Enver Hoxha në Shqipëri.

Enver Hoxha nuk kishte koqe për formulën e sockomunizmit kontinental.

Shqipëria politike nuk kishte kaçik për formulën e sockomunizmit kontinental.

Edhe Skënderbeu nuk kishte koqe kontinentale.

Prandaj të gjithë eunukët shqipërias, qe prej zanafillës, përfundojnë eunukisht.

Ka shqipërias të lazdruar që si nëpër hundë donë të nxjerrin përfitim kontinental dikund tjetër. I përmendin dofarë bashkëpunimesh ndërfamiljare midis shqipëriasve dhe hebrenjve gjatë luftës së dytë. Sikur shqipëriasit atë kohë i paskan mbrojtur hebrejt.

Nga kyfarë bashkëpunimi shqiptarohebre mendohet të nxirret njëfarë përfitimi.

Si gjithmonë, edhe këtu gabohet!

Hebrejtë e kanë zotin e vet me koqe, profetin me koqe, tempullin e vet, religjionin e vet, librin e vet, gjuhën e vet, kodin e vet.

Hebrejtë pas dymijë vjetësh diaspore u kthyen në Izraelin e vet.

Bretkosës shqipëriase i mungojnë të gjitha paradigmat e entiteteve.

Bretkosa shqipëriase vetëm kur gjendet brenda kënetës e ruan përkatësinë e racës biologjike.

Shqipëriasi posa del jashtë familjes biologjike e humb përkatësinë e racës.

Këtë formulë e jep Ben Blushi në librin Të jetosh në ishull".

Këtë formulë e provoi Enver Hoxha në fund të rravgimeve nëpër pazaret evroaziatike.

Në librin "Të jetosh në ishull" Ben Blushi provon t'i zbusë Muhamedin e Jezusin brenda familjes biologjike të Ibrahimit.

Në politikën e tij Enver Hoxha mendon t'i zbusë: Marksin, Leninin, Stalinin, Mao Ce Dunin, brenda Shqipërisë biologjike.

Të dy llojet e këtyre profetëve kontinentalë kishin koqe tepër të mëdhaja për kaçikun e Shqipërisë politike.

Ben Blushi len për të shpresuar tek libri "Të jetosh në ishull".

Ai e selekton Bretkosën shqiptare të Darvinit.

Fshatari, me emrin e përkohshëm Ibrahim, brenda ditës zgjohet i krishterë e ngryset mysliman. Ky fshatar shet e blen religjion, siç shet e blen krypë, aqsa i nevojitet për nevojat familjare.

Ibrahimi i Ben Blushit nuk kapardiset t'i pajtojë religjionet për hir të bashkimvëllazërimit të të krishterëve e myslimanëve shqipërias.

Pazari i Ibrahimit bëhet sipas standardeve të Formulës [P=NT + 1t – 1t].

Të tjerët protagonist bëjnë pazare sipas Formulës së bankrotuar.

Ali Tepelena në Janinë, Halil Patrona në Stamboll, Marin Kurila në Voskopojë, bëjnë pazare të gabuara sipas Formulës së bankrotuar [P= + 1t – 1t – Nt].

Ben Blushi na shpie të mendojmë se duhet ndërrua njësitë matëse të prijësave shqiptarë.

Tjetër është çka flasin historianët për këta prijatarë e tjetër është çka flasin këta prijatarë për vetjet e veta.

Qysh nga Skënderbeu, prijatarët shqiptarë kanë provuar t'i shesin delet e tyre nëpër pazaret e Eurounionit e të Euroazisë me çmime kineze.

Saherë nuk u shiteshin delet nëpër këto pazare udhëheqësit shqiptarë e shitnin vetveten e tyre.

Dy herë gabim!

Duke i parë të gjitha këto pazare të dështuara shqipëriasit e Shqipërisë politike të vitit 1997 vendosen të sofistikohen për pazaret e Euroazisë.

Vendosen të tregohen më cincarë.

Shtetasit shqipërias të vitit 1997 e kishin kuptuar se Shqipëria dele nuk shitet ashtu kuturu, ashtu toptan. Prandaj vendosen ta demolojnë Shqipërinë politike në copa-copa. Të demoluar, ashtu në copa-copa, e trafikuan nëpër pazaret e Euroazisë. I varen copat e Shqipërisë së trafikuar neper çengelat e tregtarëve evroaziatikë duke u dhenë çmime kineze.

Ibrahimi i Ben Blushit, i cili ua ka ulur pazarin profetëve në çmimin e një deleje, stepet nga pazaret e cicarëve shqipërias të vitit 1997. Cincarët shqipërias të vitit 1997 i ekspozonin copat e Shqipërisë zyrtare të ambalazhuara me "disidencë" nën etiketën "Made in Albania".

Cincarët shqipërias të vitit 1997 e kishin provuar dështimin e Enver Hoxhës neper pazaret e Jugosllavisë, të Bashkimit Sovjetik, ë Kinës, të Vietnamit, të Kubes, të Kamboxhës e të pazareve latinoamerikane.

Cincarët shqipërias të vitit 1997 e kishin provuar se Enver Hoxha, me kot i kishte ndërruar të gjitha fete nëpër pazaret euroaziatike pa arritur ta shesë Shqipërinë dele. Më në fund e kishin provuar se Enver Hoxha, i zhgënjyer nga këto pazare, vendosi ta bëjë Shqipërinë zyrtare ishullin më ekologjik në botë.

* * *

Enver Hoxha, i zhgënjyer nga pazaret e Euroazisë, e merr mundimin t'ua projektojë shqipëriasve të vet ishullin më ekologjik në botë duke e mohuar çdo aventurë jashtë familjes biologjike.

Po këso radhe na shërben korrespondimi. Delja e Ibrahimit të Ben Blushit le të korrespondojë me Shqipërinë e Enver Hoxhës. Ibrahimi le të korrespondojë me vetë Enver Hoxhën e do të shohim se mikroprototipi dhe makroprototipi qëndrojnë në pozicione brenda dy formulave të ndryshme.

Qe të dy i japin informatat e llojit.

Edhe pse Enver Hoxha e meriton funksionin e makroprototipit bashkështetasit e tij të Shqipërisë e mohojnë. Provojnë ta nxjerrin dhunshëm jashtë librit, jashtë funksionalitetit, jashtë meritës, jashtë varrit, qoftë kur e

lavdojnë qoftë kur e mallkojnë. Në të dy rastet, duke e përjashtuar nga funksionaliteti i prototipit, Enver Hoxhën bashkështetasit e tij aksidentalisht e shpallin zot të vetmuar e pastaj Lucifer të vetmuar në Shqipëri. Poaq aksidentalisht të gjithë shtetasit e Shqipërisë zyrtare vetveten e tyre e shpallin "disidentë".

Shqipëriasit nuk munden pa Enver Hoxhën.

Në të dy rastet Enver Hoxhës i është bërë padrejtësia më e madhe në Shqipërinë zyrtare.

Me Enver Hoxhën shtetasit e Shqipërisë zyrtare gabimisht i kundërvihen prototipit, i kundërvihen shkencës, i kundërvihen logjikës, i kundërvihen moralit. Sikur Enver Hoxha të pranohej prototip zyrtar në Librin e Shqipërisë zyrtare atëherë ky prototip do t'i jepte informatat e sakta të llojit të vet, të bashkështetasve të vet aqsa jep informata të llojit të vet Bretkosa e Darvinit.

Shqipëriasit "disidentë" mundohen t'i mëshehin informatat e llojit duke e "braktisur" Enver Hoxhën.

Si do të dukej Bretkosa e e Darvinit sikur t'i shtrembëronte informatat e llojit në mënyrë që bretkosat tjera të Kënetës së Darvinit ta shpallin veten kafshë fisnike - kafshë krejtësisht "disidente"?

Atëherë kjo Bretkosë kënd do ta përfaqësonte?

Askënd!

Atëherë bretkosat e kënetës së Darvinit dalin kafshë shumë më fisnike se shtetasit e kënetës së Enver Hoxhës.

Enver Hoxha, edhe pse "bojkotohet" si prototip i shqipëriasve, mbrëmjen e njëzet të shkurtit të vitit 1991, spektakularisht para kamerave të televizioneve më të njohura të botës, i jep informatat më të sakta për të gjithë bashkështetasit e vet eksikë të Shqipërisë zyrtare. Këtë mbrëmje e sheh e gjithë bota se sa të njëzuar janë midis tyre Enver Hoxha dhe shtetasit e vet.

Asnjeri nuk mundet pa tjetrin. Të dytë i përkasin Formulës së bankrotuar.

Sipas kësaj formule shtetasit e Shqipërisë zyrtare menduan se duke e shpallur Enver Hoxhën diktator të vetmuar, krejtësisht aksidental, do ta bindin Eurounionin se të gjithë shqipëriasit, përveç Enver Hoxhës, na paskëshin qenë "disidente". Se të gjithë shqipëriasit e meritojnë Eurounionin pas aktit aq "heroik" të mbrëmjes së njëzet shkurtit të vitit 1991 në sheshin e Tiranës.

Enver Hoxha u "flijua" nga bashkështetasit e vet i fundmi nga socdiktatorët e Euroazisë.

Edhe një herë Enver Hoxhës iu bë një promovim nga "disidentët" e Tiranës.

Bashkëkombasit e Enver Hoxhës u katandisën për ta mëshehur përkatësinë kolektive të llojit me "heroizmin" e mbrëmjes së njëzet të shkurtit.

Shtetasit e Shqipërisë disidencën ruse e kuptuan gabimisht. Bile edhe e aktruan gabimisht duke aluduar për Solzhenicinin kontinental.

Euroamerika e pranoi kompromisin me“Perestrojkën”e Gorbaçovit.

Kompromisi i Euroamerikës dhe i Socrusisë ishte kontinental.

Shqipëria e Enver Hoxhës nuk kishte kaçik të marrë pjesë në këtë kompromis kontinental me imitimet aq qesharake të mbrëmjes së njëzet shkurtit të vitit 1991.

Kompromisi politik kishte filluar shumë më parë midis Euroamerikës dhe Socrusisë.

Euroamerika, qe nga fillimi i këtij kompromisi, e dinte qartë se Pasternaku, Solzhenicini, Hrushçovi, Gorbaçovi, Jelcini, janë prodhime të falsifikuara të Socrusisë sipas parametrave të Formulës së bankrotuar [P= + lt – 1t – Nt].

Shqipëriasit e Shqipërisë politike gabojnë kur mendojnë se do të bëjnë pazar sikur Socrusia me tyxharin Euroamerikan.

Tandemi Hrushçov Solzhenicin hyri drejtpërdrejt në pazar me tyxharin Euroamerikan.

Tyxhari euroamerikan e njihte cilësinë e dobët të ofertës Socruse. Atij i mjaftonte vetëm ta fillojë pazarin. Pastaj shohim bëjmë.

Nikita Hrushçovi, nëpërmes Referatit sekret mbi krimet e Stalinit, synonte t’ia shesë Perëndimit Formulën e bankrotuar [P= + lt – 1t – Nt].

Ç’do të thoshte kjo formulë për Nikita Hrushçovin?

Krejt e qartë!

Nikita Hrushçovi, nëpërmes Referatit Sekret e që nuk ishte aspak sekret, e sakrifikoi Stalinin sipas Formulës së bankrotuar. Hrushçovi e sakrifikoi Stalinin për ta shpëtuar Rusinë tok me dyqind milionë rusë.

A s’ju duket mjaft !?

Aleksandër Solzhenicini, nëpërmes librave të ndaluara publikisht por të lejuara nga vetë Hrushçovi, e sakrifikoi Stalinin për ta shpëtuar Rusinë e, tok me të edhe dyqind milionë rusë.

Tek veprat: “Pavijoni i kancerit”, “Arkipelagu gulag” e, veçant tek “Rrethi i parë”, Solzhenicini e sakrifikoi Stalinin duke ngulmuar që të mos e bëjë prototip. Solzhenicini ngulmon t’ia mbyllë gojën Stalinit.

Si prototip zyrtar Stalini do të fliste ndryshe.

Si Prototip Stalini do ta denoncojë Rusinë tok me dyqind milionë rusët e saj.

Hrushçovi, Solzhenicini, pastaj vistër të tjerët, e paraqesin Stalinin diktator aksidental, krejtësisht të vetmuar, midis dyqind milionë rusëve “disidentë”.

Kështu mendon ta shpëtojë Rusinë e tij Aleksandër Solzhenicini. Por Solzhenicini bën tregti me Euroamerikën me mall të falsifikuar rus sipas Formulës së bankrotuar [P = + 1t – 1t – Nt].

Dyzet vjet më vonë Formulën e Solzhenicinit e vërtëton Vladimir Putini.

* * *

Shqipëria nuk e ka as gjasën më të vogël të bëjë tyxharllëk me Euroamerikën, ashtu siç bënë në kohën e tyre Hrushçovi e Solzhenicini.

Natyrisht se Shqipëria do të mendojë se kur Hrushçovi e Solzhenicini tregtuan me Euroamerikën sipas parametrave të Formulës së bankrotuar [P= + 1t – 1t – Nt], atëherë pse të mos e bëjnë edhe shqipëriasit këtë tregti me Euroamerikën?

Po qe se Hrushçovi e Solzhenicini e deponuan në bankat e Euroamerikës Stalinin si diktator të vetmuar të Rusisë dyqindmilionshe, pse të mos e deponojnë edhe Enver Hoxhën shqipëriasit?

Bile ai Solzhenicini, po edhe Pasternaku e Mihail Sholohovi, arritën të bëjnë pazar me sarafin e dinamitit - me atë Alfred Nobelin.

Shqipëriasit ia hynë kësaj tregtie me Euroamerikën si Bretkosa e La Fonteinit

Shqipëriasit, mbrëmjen e njëzet shkurtit të vitit 1991, pasi e zvarritën Enver Hoxhën nëpër rrugën e Golgotës së Tiranës, e prenë me sharrë elektrike. Ashtu pjesë-pjesë, provuan ta trafikojnë në trezorët e bankave të Euroamerikës për deponim.

Shkrimtarët shqipërias, të Enverit e të Salihut, lukunisht, u vetëshpallën e i vetëshpallën "disidentë".

Shkrimtarët "e përndjekur", të Salihut e të Enverit, lukunish u arratisën kah sarafhania e atijfarë Nobelit, sikur kyfarë Nobeli të kishte hapur kiosqe në Laprakë.

Pse të mos e bëjnë këtë yrysh shkrimtarët e Enverit e të Salihut?

* * *

Në të gjitha letrat e Shqipërisë politike shqipëriasit e kanë identifikuar vetjen e tyre si viktima kujdestare të pushtuesve kujdestarë sipas Formulës së bankrotuar [P= + 1t – 1t – Nt].

T'i akuzosh pushtuesit pse e kanë pushtuar Shqipërinë është shumë. Ta çfajsosh vetjen prej viktime pse nuk ke qenë në gjendje ta mbrosh Shqipërinë është edhe më shumë.

Në të dy rastet, pushtuesit dhe të pushtuarit, u hiqen paradigmat e tërësisë psikofizike [Nt]. Do të thotë pushtuesi reduktohet vetëm në një tipar negativ [- 1t]. Pushtuesi del një krijesë shumë e varfër, krejt e pabesueshme për vetjen e vet. Në këtë mënyrë shtetasi Shqipërisë zyrtare, diakronikisht, mësohet të bashkëjetojë me inferioritetin vetjes së vet prej viktime [+ 1t].

Shtetasi i Shqipërisë zyrtare duke e identifikuar vetjen si viktimë të virgjër e përjashton vetveten nga historia, nga atdheu dhe nga mundësia e të jetuarit.

Me këtë paradigmë mangut, shkrimtarët e Enverit e të Salihut, ashtu lukunish, ia mësyejnë "kurvës" Europë. Shqipëriasit duke e identifikuar vetjen me viktimën e virgjër, tyxharhanën e Europës e kishin shpallur njëfarë bordeli "kurvash të trishta".

Çfarë mentaliteti prej Isa Boletini !

Çfarë mentaliteti prej Oso Kuke !

Çfarë mentaliteti prej humbësi !

Shqipëriasve të Naim Frashërit u bie për hise detyra më absurde. Krejt si në mitin mbi Sizifin, u bije hise ta pajtojnë Kazanovën e "bordelit" europian me Osama bin Ladenin, për ta kombinuar njëfarë "bektashizmi" autokton.

Shqipëriasi e pati të pamundshme t'i vëllazërojë këta dy burra të cilët sot nuk po mund t'i vëllazërojë as Euroamerika.

Atëherë në skenë u shfaq absurdi Gjergj Fishtë me flamujt e folklorit hardall dhe të krishtënizmit gacator.

Në Veprën "Lahuta e malsisë" Gjergj Fishta e bën punën më absurde të Sizifit.

Në çdo të dytin varg i rrokulliset guri i Sizifit tëposhtë kodrës deri në rranzë.

Në këtë vëpër çdo i dyti varg i tepron Gjergj Fishtës.

I tepron trimëria, i tepron besa, i tepron morali, i tepron patriotizmi, i tepron atdheu, i teprojnë të gjitha.

Gjergj Fishta fundekrye tek "Lahuta e malsisë" e përdor Formulën e bankrotuar [P= + 1t – 1t – Nt].

Oso Kuka, burrë tepër i dyshimt profesionalisht e bashibozuk, han fre ta bëjë trimërinë më absurde!

Oso Kuka me dyzet bashibozukë, pa kurrfarë strategjie ushtarake, pa kurrfarë pajisje ushtarake, pa kurrfarë stërvitje ushtarake, kapton nga Shkodra e del në teatrin e Vraninës. Ai han fre për t'i mbrojtur kufinjt e Perandorisë turke. Me këta dyzet bashibozukë rrehet ta sfidojë perandorinë e

Rusisë. Oso Kuka, qe në fillim, përcaktohet detyrimisht për humbës, e vetëm për humbës.

Shqipëriasit, gjithmonë e fatalist, vetëm ia rregullojnë bilansin armikut.

Midis mbrojtjes së kufijve turkoshqiptarë dhe vdekjes teatrale, krejtësisht absurde, krejt sipas rregullës, qysh në fillim, Gjergj Fishta për Oso Kukën e zgjedh vdekjen krejtësisht teatrale në teatrin e Vraninës.

Ky Don Kishot absurd e aktron vdekjen për t'u bërë hero i Lahutës. I pëlqen lahuta – nuk i pëlqen Shqipëria.

Oso Kukës i tepron vdekja, i tepron trimëria brenda formulës së bankrotuar [P=+1t – 1t – Nt].

Trimëria teatrale dhe absurdi kanë qenë dhe kanë mbetur padronë, sot e gjithë ditën e zotit, në teatrin absurd të Shqipërisë zyrtare.

Gjergj Fishta na e zbulon për titërr të diellit paaftësinë e Oso Kukës që të jetojë për atëfarë Shqipërinë e tij.

Oso Kuka është i aftë vetëm të vdesë teatralisht por jo të jetojë.

Armiku superior ndaj kësajfarë Shqipërie të Oso Kukës, siç ishte Rusia e kral Nikollës së Malit të Zi, do t'ua blatonte të gjithë shtetasve të kësajfarë Shqipërie trimërinë e absurdit teatral të Oso Kukës.

Le të ndalojmë paksa!

Çka do t'i bije ndërmend udhëtarit kosovar, kur merr rrugë për tek Ulqini i Sabatai Sevit?

Udhëtari kosovar, në cep të rrugës, buzë liqenit të Shkodrës, tek cukali i Oso Kukës, do ta shohë një tabelë paksa si të turpshme, në të cilën shkruan "Vranjina".

Ky udhëtar kosovar do të mendojë:"Sot Vranina qenka në Mal të Zi!?

Po!

Atëherë Oso Kuka paska vdekur gabimisht!"

E saktë!

Jo vetëm kaq!

Oso Kuka edhe paska jetuar gabimisht!

Gjergj Fishta katandiset të bëjë hero nga Oso Kuka sipas formulës alkimiste [P=+1t – 1t – Nt].

Kjo do të thotë se Oso Kukës i tepron trimëria teatrale e vdekjes absurde [+1t].

I mungon mençuria e jetës{- 1t}.

Në të njëjtën kohë i mungonjnë të gjitha tiparet e njeriut të njëmendt [-Nt].

Oso Kuka bën diversion në veprën "Lahuta e malsisë".

Oso Kuka bën diversion në jetën e shqipëriasve të vet.

Pse!

Oso Kuka i mban peng bashkështetasit.

Shtetasi i Shqipërisë zyrtare ka qenë prore i detyruar të rrije cuc para Oso Kukës politik, pa arritur kurrë të barazohet me të. Nëpërmes këtij heroi absurd, shtetarët e Shqipërisë zyrtare e kanë mbajtur shtetasin e vet nën trysninë e fajit.

Krejt sipas rregullës, shtetasi i Shqipërisë zyrtare kurrë nuk mund ta ekzekutojë aktin e vdekjes dramatike të Oso Kukës. Atëherë detyrimisht e pranon fajin e shtetasit tradhtar.

Oso Kuka ven tagër.

Për shumëkend bëhet gur varri, derë burgu, spiun, denoncues.

Pushtetarët, me ndihmën e Oso Kukës, mund ta manipulojnë shtetasin në gjithfarë mënyrash deri tek dënimet më të skajshme.

Gjergj Fishta i Shqipërisë politike vullnetarisht bëhen shkrimtar i "cometes" shtetërore.

Po i cilit shtet?

Gjergj Fishta shitet e blihet tek shteti sipas Formulës së bankrotuar [P=+ 1t – 1t – Nt].

Gjergj Fishtës i tepron vdekja [+ 1t].

Gjergj Fishtës i mungon jeta [- 1t].

Gjergj Fishtës i mungon njeriu [- Nt].

* * *

Po pse Enver Hoxha katandiset ta zhdukë Gjergj Fishtën?

Edhe Enver Hoxha shitet e blihet sipas Formulës së bankrotuar.

Enver Hoxhës i tepron vdekja [+ 1t].

Enver Hoxhës i mungon jeta [- 1t .

Enver Hoxhës i mungon njeriu[- Nt].

Të gjithë shtetarët e Shqipërisë politike, prej atijfarë Skënderbeut e deri tek kyfarë Salihu, shiten e blihen krejt sipas kësaj Formulës fatale- [P=+1t – 1t – Nt].

Të gjithë shtetarët shqipërias, prej atijfarë Skënderbeut e deri tek shqipëriasit e vitit 1997, kush me copa prej feudesh nën sqetull e, kush me Shqipërinë toptan, ua mësyejnë pazareve të Euroazisë për ta shitur Shqipërinë me çmimin e një deleje.

Enver Hoxhës, sipas Formulës së bankrotuar, herë i tepronte herë i mungonte një dele.

Por përherë i mungonte tufa e deleve.

Por pazaret evroaziatike i ndoqi njënganjë.

Ditën e parë Enver Hoxha e nxori delen Shqipëri në vasharin e Shumadisë jugosllave.

Edhe pse jugosllavët ia lavdëruan delen Shqipëri përtej mase, nuk arrijtën t'ia blejnë, qoftë edhe me çmimin më të lirë kinez.

Enver Hoxha, i zhgënjyer nga pazari i lig jugosllav, vendosi ta ndërrojë fenë.

Hyri në kishën ruse dhe i tha patriarkut:

"Dua ta ndërroj fenë".

"Pse do ta ndërrosh fenë?"- e pyeti patriarku rus.

"Sepse feja e Stalinin është feja e perandorisë nga e cila vijnë ligjet më të mira të botës" – u përgjigj Enver Hoxha.

Pasi patriarku rus ia shpjegoi të gjitha rregullat e fesë së Stalinit, Enver Hoxha doli nga dera e prapme e kishës, tek e kishte lidhur në kopsht delen e hajthme Shqipëri.

Të nesërmen e nxori Shqipërinë në pazarin e lirë të muzhikëve të Stalinit. E kishte zbukuruar delen Shqipëri me të gjitha shenjat ideologjikë të sockomunizmit sovjetik.

Tërë ditën e zotit u ngrehaluc Enver Hoxha nëpër pazaret e tyxharit Stalin. Pas shumë lëvdatash për Shqipërinë sockomuniste, tyxharët rusë u prishën në pazar me Enver Hoxhën.

Shqipëria sockomuniste e Enver Hoxhës nuk u shit.

Po atë ditë në qiellin e Enver Hoxhës u shfaq kometa e re.

Misionarët aziatë ia kumtuan Enver Hoxhës përparësitë e pazarit kinez.

I doli si vështirë ta bëjë rrugën e gjatë deri në Kinë. Delja e hajthme Shqipëri i lodhej rrugës së gjatë.

Tek Muri i madh kinez ia kontrolluan mallin e zbukuruar ende me shenjat e sockomunizmit rus. Por Enver Hoxha tregoi se kishte vendosur ta ndërrojë fenë.

Kishte vendosur ta marrë fenë kineze.

" Pse do ta marrësh fenë kineze?" – i thanë kinezët.

"Sepse ligjet më të mira të botës vijnë nga Perandoria e Kinës" – u për-gjigj Enver Hoxha.

Edhe këtu në Kinë ia lëvduan Shqipërinë sockomuniste. Gati sa nuk e bënë Shqipëri kineze.

Si zakonisht, u prish në pazar edhe me kinezët.

Posa doli nga pazari kinez, disa kontrabandistë ia sugjeruan pazarin vietnamez. I thanë se vietnamezët janë antiamerikanë të përbetetuar. Ata do ta blejnë Shqipërinë për inat të amerikanëve.

Serish i duhej ndërruar fenë.

"Pse do ta marrësh fenë vietnameze?"- e pyetën vietnamezët.

"Sepse ligjet më të mira vijnë nga perandoria e Vietnamit. Sepse vietnamezët e urrejnë imperializmin amerikan." - u përgjigj Enver Hoxha.

Heret, në mëngjes, Enver Hoxha e nxori delen Shqipëri në pazarin vietnamez.

Qe në fillim u pa shikimi vëngërt i tyxharëve vietnamezë. Oguri i një pazari të lig u pa.

Duke dalë, i dëshpëruar, nga pazari vietnamez, Enver Hoxha e kuptoi se pazaret u sosën se fetë u sosen.

Ende nuk e kishte shitë Delen Shqipëri.

Thellësisht i dëshpëruar, Enver Hoxha u detyrua të kthehet në shkarrëzinën ballkanike, i bindur se Shqipëria, qëllimisht ishte mbaruar keq nga imperialistët austriakë. Ai e kuptoi se austriakët e ndërtuan një Shqipëri torzo, një palimpset të gabuar mbi një pergamenë të gabuar.

Austriakët e kishin bërë një Shqipëri pa zot, pa profet, pa tempull, pa religjion, pa libër, pa gjuhë, pa institucion, pa shtet, pa pushtet - kryesisht pa kod.

Enver Hoxha, tepër i zhgënjyer, e mori për të vërtetë se Shqipëria e tij nuk u shit në asnjë pazar shkaku i këtyre mungesave. E kuptoi se shtetasi i Shqipërisë është një krijesë njëvalentëshe, se është palimplest i kopjuar shumë keq tek zoti i huaj, tek profeti i huaj, tek tempulli i huaj, tek feja e huaj, tek shteti i huaj, tek pushteti i huaj, tek libri i huaj, tek atdheu i huaj.
Enver Hoxha e kuptoi se shtetasi i Shqipërisë zyrtare mbetet një kopje e zvetënuar.

Më në fund Enver Hoxha e zbuloi - teorikisht mjaft saktë - formulën e shtetasit të Shqipërisë zyrtare. E kuptoi qartë se shtetasit të Shqipërisë së tij zyrtare i mungonte kodi social. Shtetasi shqipërias kishte vetëm kod biologjik – brenda familjes.

Kur u përpoq të ndërhyjë në këtë kod Enver Hoxha, fatalisht, e bëri një palimplest edhe më të keq se ai palimplesti austriak.

Edhe Enver Hoxha i mbeti besnik formulës së gabuar [P=+1t – 1t – Nt].

I dëshpëruar nga pazaret e liga të shteteve revizioniste, Enver Hoxha provoi ta ndërtojë Socshqipërinë brendapërbrenda kufijve biologjikë të familjes.

Ky shtet - i paprovuar ndonjëherë më parë e as më vonë - do të ipte rezultat sikur Enver Hoxha të mos e provokonte familjen biologjike me solucione te falsifikuara socpatriotike

Enver Hoxha nuk arriti të kuptojë vetëm aqsa kuptoi Prototipi Ibrahim i Ben Blushit.

Ibrahimi i Ben Blushit i konsumon religjionet edhe profetët, aqsa i nevojiten familjes së vet për ekzistencë. Ibrahimi i Ben Blushit i blen në pazar religjionet, profetët, siç i blen të gjitha nozullimet shtëpiake, krejt sipas formulës biologjike [P=Nt+1t – 1t].

Ibrahimi i Ben Blushit, diakronikisht dhe sinkronikisht, u tregon shqipëriasve të vet se gjithmonë i kanë bërë pazaret gabimisht. Prej atij Skënderbeut e deri tek viti 1997 i shtetasve të Salihut e të Enverit, shqipëriasit janë treguar pazarxhij të prapë. Saherë shqipëriasit kanë provuar ta shesin Shqipërinë, qoftë kuturu qoftë pjesë-pjesë, e kanë zbuluar natyrën e vet prej trafikantësh e kontrabandistësh.

Kësaj natyre shqipëriase nuk arriti t'i reshtet as Enver Hoxha nëpër të gjitha pazaret evroaziatike.

* * *

Për herë të parë, në të gjitha letrat e diakronisë e të sinkronisë së Shqipërisë zyrtare, në librin "Të jetosh në ishull" shpallet Formula krejtësisht e saktë e Prototipit biologjik. Për herë të parë, jo vetëm për Shqipërinë e Ballkanit, por edhe më gjërë, Ben Blushi e jep Prototipin sipas formulës [P=Nt – 1t + 1t].

Ky prototip del tepër i urryer për patriotët, për fetarët, për moralistët, për sockomunistët.

Ibrahimi i Ben Blushit brenda një dite bëhët një plus mysliman e një minus i krishterë.

Ibrahimi i Ben Blushit e ngacmoi pasionin prej trafikantësh. Shqipëriasit e krishterë dhe myslimanë, me huliganizmin e çpifur të tifozëve, iu ngërdheshën njëri-tjetrit.

Në këtë katrahurë diletantësh race, shtetarët e Shqipërisë zyrtare kanë nevojë urgjente për trajtim të thellë hospitalor. Vetëm pas këtij trajtimi mund ta dallojnë Bretkosën e La Fonteinit nga Bretkosa e Darvinit.

Bretkosat e La Fonteinit [Kadare-Qosje], pa e mëtuar njëri i gjallë brenda tokës e qiellit, ndërkyeshëm turret të përzihet në konfliktin kontinental midis eurokrishterëve e arabomyslimanëve.

Në këtë konflikt kontinental Bretkosat e La Fonteinit shqipërias asnjërës palë nuk mund t'i ndihmojë vetëmse çahen vegësh.

Me lektisjen e Bretkosës së La Fonteinit shqipërias, Enver Hoxha hyri në beteja singulare kundër Romës kristiane, Bizantit ortodoks, Mekës fondamentaliste, Moskës e Pekinit revizionistë, Vashingtonit imperialist, Izraelit sionist.

Sfidim madhështor!

Edhe më madhështor bëhet Enver Hoxha kur lektis ta bëjë Tiranën e Shqipërisë zyrtare qendër pelegrinazhi për të gjithë marksistët e leninistët e reformuar të botës.

E në botë kishte e ka shumë.

Vërtet sfidim madhështor!

Shqipëria zyrtare u bë tepër e vogël për figurën e Enver Hoxhës.

Ai kur shtrihej për të pushua, këmbët i shpërlante në detin Mesdhe e kokën e mbështeste dikund në Alpe.

Bënte tregti me profetë, me religjione, me tempuj, me ideologji. Shitej e përshitej sipas pazarit më fatkeq.

Vërtetë figurë madhështore!

Traditë e titajve liberatorë që ç'ke me të!

Edhe sot e gjithë ditën e lume të zotit, yllkat e çerdheve të xhaxhit Enver e njohin vetëm Bretkosën e La Fonteinit ideologjik.
Kurrsesi ta njohin Bretkosën e Darvinit.

Këto yllka të çerdheve të xhaxhit Enver, sa çel e mshel sytë, u benë demokratë, u benë "disidentë".

Krejt sipas rregullës këta "disidentë" u benë shtetarë,

Krejt sipas rregullës këta "disidentë" u benë uzurpatorë të Shqipërisë politike.

Nëpërmes yllkave të çerdheve xhaxhi Enver edhe sot sundon në Shqipëri, bile edhe si socialist edhe si "demokrat" edhe si "republikan".

* * *

Prototipi Ibrahim i veprës "Të jetosh në ishull" mëton ta promovojë saktësinë e parë biologjike të Shqipërisë zyrtare.

Ky Prototip, i promovuar sipas formulës shkencore [P=Nt+ 1t – 1t] na e jep saktësisht kufirin e të të gjitha pazareve që mund ta bëjnë shtetarët e Shqipërisë politike.

Duhet mësuar se cilën formulë, nga këto të dyja, e pranon tyxhari i Eurounionit. Duhet mësuar salihët se cilën Shqipëri do ta nxjerrin këtë herë në pazarin euroamerikan ose në Konferencën Arabomyslimane.

Salihët e sotëm shqipërias le të mësohen ta dallojnë pazarin e NATO-s nga pazari i Eurounionit. Tyxhari gjeoushtarak i NATO-s interesohet vetëm për tokat, qofshin ato edhe djerrina, siç i gjeti tokat e Ishtraktatit të Varshavës. Pazarit të NATO-s nuk i intereson aspak, te fundi, se cilës formulë i përket shtetasi i djerrinës ishsocialiste. Nuk i intereson kualiteti i kodit civil as i kodit biologjik të këtyre shteteve.

Vetëm pazarit të Eurounionit i duhet formula e shtetasit. I duhet kodi civil e kodi biologjik i këtyre shteteve

Në Unionin evropian nuk mund të hyjë djerrina e shtetasve të formulës së gjymtë [P=+1t – 1t –Nt].

Në Unionin evropian, ku edhe synon të hyjë Shqipëria e sotme, mund të hyjnë vetëm shtetasit e Formulës [P=Nt + 1t –1t]. Prandaj shtetarët e Shqipërisë salihe gabojnë kur i përziejnë gëzimin e të pranuarit në NATO e gëzimin e të pranuarit në Unionin evropian.

Pranimi në NATO mbetet pranim mekanik, teknik, territorial, pranim i tipit kazermë.

Pranimi në Unionin evropian do të thotë integrim ekonommik, social, psikomental integrim i kodit civil e biologjik.

Sot, më mirë se kurrë, po e shohim se shumë shtete djerrina kanë hy në NATO por një zot e di a do të hyjnë ndonjëherë në Unionin evropian.

Pikërisht në këtë pikë referuese e kemi fjalën.

Shqipërisë zyrtare, sot, më shumë i shërben Formula [P= Nt + lt – 1t] se sa të gjitha politikat diakronike e sinkronike të të gjithë presidentëve, kryeministrave, ministrave, parlamentarëve, ideologëve, shkrimtarëve, historianëve, luftëtarëve të Shqipërisë zyrtare.

Prototipit Ibrahim, ia jep Eurounionit mesazhin kumt më të qartë. Ia jep mesazhin kumt se në cilën shkallë të evoluimit biosocial duhet gjurmua identitetin e shtetasit të Shqipërisë zyrtare. Ben Blushi i librit "Të jetosh në ishull" ia zbulon shkencorisht Europës, pa e quajtur "kurvë të motit" se Prototipi Ibrahim sipas formulës [P=Nt + 1t – 1t] mund të bëhet qytetar i Brukselit. Ia shpjegon Eurounionit se Prototipi Ibrahim nuk mund të bëhet

fundamentalist mysliman, taleban, alkaid, apo ndonjëllojlloj trafikanti sockomunist sovjetikokinez.

Kaq shumë mund të bëjë një libër?!

Po! Kaq shumë

* * *

Gjithmonë Prototipi risimtar hasë në pengesë.

Shtetasit e Shqipërisë zyrtare e ndjejnë veten tepër të fyerë nga Ibrahimi i Ben Blushit.

"Si na qenka e mundur që një prototip i Ben Blushit ta ndërrojë fenë aq kollajshëm, pa fijen e moralit"!?" – pyesin shqipëriasit e fyer të gradës së Fatos Lubonjës.

Vetëm pse nuk iu shit një dele!?

Ky lexues njëvalentësh i Shqipërisë njëvalentëshe të gradës së Fatos Lubonjës spikatet oportun, demagog, kur e di se sa shumë herë shqipëriasit kanë provuar t'i vjerrin nëpër çengelat e pazareve euroaziatike copat e Shqipërisë së zhvatur për çmime kineze sipas formulës së bankrotuar [P=+ 1t – 1t – Nt]. Ky lexues oportun ishte gati i moshës së sotme në vitin 1990 kur shqipëriasit e ditën "disidente" të dy korrikut e braktisën aq egërsisht e aq kolektivisht Shqipërinë e Enver Hoxhës. Ky lexues oportun shqipërias ishte gati i moshës së sotme në vitin 1997 kur shqipëriasit brenda një nate u lugatësën në "disidentë" sipas Formulës së bankrotuar.

Fatalisht, sot e gjithë ditën e zotit, pi ujë thënia aq fatale e llaskucit të përgëdhelur Faik Konica: "Shqipëria u bë për inat të shqiptarëve!"

Vërtet Ibrahimi i veprës "Të jetosh në ishull" shet e blen religjion me çmimin e një deleje.

Ibrahimi i Ben Blushit brenda ditës e shet ca krishtenizëm e blen ca myslimanizëm.

Për moralin, patriotizmin, religjionin, njeriu mund të jetë kuturu i ndershëm apo kuturu pusht, duhet të jetë kuturu patriot apo kuturu tradhtar, kuturu i krishterë apo kuturu mysliman.

Njeri të tretë nuk ka.

Për fenë myslimane Ibrahimi bëhet i devotshëm.

Për fenë e krishterë ibrahimi anatemohet.

Kaq e thjeshtë del puna e Ibrahimit brenda ditës së dy feve.

Në mbrëmje Ibrahimit e mbyll bilansin vetëm me një minus më pak krishtenizëm e me një plus më shumë myslimanizëm.

Moralistët sedertarë të gradës së Fatos Lubonjës këtë Ibrahimin e Ben Blushit do ta quanin interesxhi të shkalluar nga dynjallëku.

Do ta shpallnin një lloj Sanço Panço shqipërias.

Prototipi i Ben Blushit, sot u vardiset shtetasve të Shqipërisë zyrtare deri në hutesë.

Ua prish pazarin shtetarëve të Shqipërisë salihe.

Po cilin Pazar?

Pikërisht pazarin e synuar në Brukselin evropian apo në Konfrenencën e vendeve islamike.

Politikajt shqipërias, me mendjet e tyre prej arixhinjsh, po e bojatisin Shqipërinë deri në çoroditje të dhimbëshme duke menduar se do t'i joshin tyxharët eurounionas e arabomyslimanë.

Këta politikaj shqipërias, të katandisur në karaxhozlleqet e cirqeve provinciale, njëpasnjë i dërgojnë kumte Eurounionit.

I dërgojnë kumte duke u çjerrë se shtetasit e Shqipërisë salihe janë me gjak të kulluar evropian.

Se në zemër e kanë krishtërimin evropian.

Se e kanë mbrojtur Europën nga barbarizmi osmanoaziatik.

Dhe, si prej qiellit të kthjellët shkrep një prototip i fuqishëm!

Shkrepi Ibrahimi i Ben Blushit.

Ai e ndërron fenë në pikë të ditës për çmimin e një deleje.

Edhe shumë më keq bile !

Ibrahimi i Ben Blushit kalon nga feja e krishterë në fenë myslimane!

Dreqopunë!

Politikajt shqipërias frikësohen se Eurounioni do ta prishë pazarin me Shqipërinë salihe shkaku i Ibrahimit të Ben Blushit.

Eurounioni do të konkludojë:

"Po këta shqipëriasit, a kaq lirë, me çmimin e një deleje, po e shitkan krishterimin"!

Kaq shumë prishka punë një libër ?!

Po ! Kaq shumë !

Politikajt e sotëm shqipërias tremben se mos Ibrahimi i Ben Blushit do t'ia kujtojë Eurounionit pazaret euroaziatike të Enver Hoxhës. Do t'ia kujtojë Eurounionit se si u katandis Enver Hoxha nëpër këto pazare euroaziatike për ta shitur Delen Shqipëri me te gjitha ato zbukurime të sockomunizmit jugosllav, sovjetik, kinez, vietnamez...kubanez.

Ibrahimi i Ben Blushit i rrezikon shtetarët e Shqipërisë salihe.

Bëhet Prototipi më i rrezikshëm në të gjitha letrat e Shqipërisë politike.

I jep të gjitha informatat e sakta të llojit të vet.

Ibrahimi i Ben Blushit bëhet Prototipi i parë që nuk pranon të trafikohet.

Shkrimtarët shqipërias i trafikojnë protagonistët e tyre të dyshimtë.

Në hejzën e trafikimit, kur shtetarët lektisin ta trafikojnë Shqipërinë dikund në Bruksel apo dikund në Konferencën Panarabike, u shfaq Prototipi Ibrahim i Blushit. Ky Prototip u bë model i saktësisë ogure për t'i korrigjuar të gjithë protagonistët, të gjithë shtetasit, të gjithë shtetarët, qoftë në sinkroni qoftë në diakroni.

Politikajt e sotëm të Shqipërisë zyrtare, me një shëndet mental që kufizon me klinikat psikiatrike, në pikë të ditës së zotit, e aktrojnë disidentin e dresuar. E shpallin Enver Hoxhën diktator të vetmuar në Shqipërinë zyrtare.

Si për Enver Hoxhën diktator, si për veten e tyre, shtetarët e sotëm të Shqipërisë salihe e përdorin të njëjten formulë të gabuar [P=+1t – 1t – Nt].

Për të dy rastet përdoret i njëjti paradoks.

Sipas këtyre shtetarëve "kurva" Evropë do ta hajë këtë qull paradoksal të salihëve.

Së pari: "kurva" Europë duhet të besojë se Enver Hoxha ishte diktator krejtësisht i vetmuar midis shtetasve të vet "disidentë".

Së dyti: "kurva" Europë duhet të besojë se shtetasit "disidentë" të Shqipërisë salihe e hoqen qafe diktatorin Enver Hoxha brenda një mbrëmjeje të shkurtit të vitit 1991.

Së treti: "Eurokurva" duhet të besojë se tashmë Shqipëria zyrtare u bë shteti më ekologjik i "disidentëve".

Së katërti: "Eurokurva" do ta marrë në gjirin e saj këtë Shqipëri kaq të virgjër.

Së pesti: "disidentët" e virgjër salihas e meritojnë të kullosin si qengja të urtë nëpër livadhet e buta të "Eurokurvës".

Prototipi Ibrahim i Blushit me natyrën e tij rrezikzezë sikur ia pështpëritë Eurounionit në vësh të gjitha informatat e llojit shqipërias.

Sipas këtyre të dhënave Prototipi Ibrahim i bën çerpaze bashkështetasit, heronjtë, zotat, profetët, tempujt, religjionet, shtetarët, shtetin, pushtetin, moralin, patriotizmin, heroizmat, librin, gjuhën.

Mund edhe të thuhet:

"Po nuk u bë nami se u shkrua një libër!

Te fundi ai është vetëm libër që edhe nuk do të merret aq seriozisht.

Ky libër as që do të lexohet në Eurounion.

Si mundet një rrezikzi, siç na doli Ibrahimi i Ben Blushit, ta rrezikojë tarafin e Shqipërisë salihe drejt Eurounionit?!".

Le të jetë kështu vetem për politikajt shqipërias.

"Eurokurva" si nën hundë po flet diçka për Bullgarinë, Rumaninë e, për të gjitha simotrat e tyre ishsocialiste.

“Eurokurva” e njeh qe moti Formulën e gjasës psikogjenetike të Prototipit.

“Eurokurva” i njeh të gjithë ekzemplarët shtetas të Shqipërisë salihe të vitit 1997.

Formula e gjasës fatalisht e bën punën e vet.

“Disidentët” e Shqipërisë salihe të vitit 1997 dhe Enver Hoxha bashkëjetojnë brenda të njëjtës Formulë të bankrotuar.

Të dytë, kush në copa e kush kuturu, e trafikojnë Shqipërinë.

Nëpër këto pazare Shqipëria kurrë nuk e kapërcei çmimin e nje deleje!

Sindromi recidiv i shtetasve psikosocialistë të Shqipërisë së Enver Hoxhës del tepër i vështirë për t’u kullandrisë.

Në të dy anët Eurounioni e ka të vështirë.

Po të pranohen brenda Eurounionit këta shtetas e sjellin pandeminë ekonomike.

Po të lihen jashtë Eurounionit do t’ia sillnin kontinentit të gjitha rreziqet e ekspansionizmin rus, falsitetin socekonomik kinez, fondamentalizmin taleban e al qaidë.

Tyxhari i Eurounionit e ka zgjedhur variantin e tretë.

Për t’u mbrojtur nga pandemia e ishshteteve sockomuniste e ka zgjedhur karantinën e NATO-s.

NATO është tyxhar tokash i tipit kazermë.

Eurounioni është tyxhar kodesh civile e biologjike.

* * *

Tyxhari NATO duhet ta dijë se çfarë tokash po blen.

Më së sakti do të mësojë nga Enver Hoxha.

Enver Hoxha e ka privilegjin të konsolidohet në prototip për llojin e vet të tregtarit me toka e me kode.

Si i tillë spikatet figura më e bindshme, figura më markante, ndër të gjithë shtetarët sockomunistë.

Përtej të gjithë burrështetasve të llojit të vet, Enver Hoxha i testoi pazaret sockomuniste.

Të gjitha i dolën mozomakeq!

Pastaj i testoi pazaret kombëtare të Skënderbeut, të Ismail Qemalit, të Fan Nolit, të Ahmet Zogut.

Të gjitha i dolën mozomakeq!

I testoi pazaret evroaziatike.

Të gjitha i dolën mozomakeq!

Në fund të këtyre testimeve, kur u sosën të gjitha pazaret, Enver Hoxha erdhi në përfundim se Delja Shqipëri nuk mund të shitet në asnjë pazar sepse i mungojnë: zoti, profeti, religjioni, tempulli, libri, gjuha, shteti, pushteti...

Në fund Enver Hoxha i mohoi të gjitha këto nocione duke i emërtuar gabime diakronike e sinkronike të Austrisë së vitit 1912.

Enver Hoxha u bë mohuesi më i madh në Evroazi.

Vendosi ta marrë barrën e kalvarit më të madh mbi shpatullat e veta.

Vendosi t'i ndërtojë nga fillimi, krejtësisht nga fillimi: zotin, profetin, religjionin, tempullin, shtetin, pushtetin, gjuhën, librin, njeriun...

Vendosi ta bëjë Shqipërinë zyrtare ishull ekologjik, ta bëjë ishull të shenjt sockomunist

Enver Hoxha synoi ta bëjë Ishullin Shqipëri konkurrent të Romës, të Konstatinopojës, të Mekës, të Moskës, të Pekinit, të Vashingtonit, të Jerusalemit.

Ndryshe shtetarëve tjerë sockomunistë, Enver Hoxha duhej bërë të gjitha qe nga fillimi.

A s'ju duket mjaft!

Po Enver Hoxha e harroi konceptin e jetës, të moshës, të vdekjes.

Me një jetë prej vdekatari vështirë ta bëjë punën e zotit.

Vdekja e zuri Enver Hoxhën dikund gjatë kësaj rruge.

Pas vdekjes së Enver Hoxhës kulmi i Kremlinit zu të pikojë.

Europa u mbush me "disidentë" të të gjitha llojeve.

Çmimi i tyre ra në bursat evropiane.

Tashmë çmimi"Nobel" i tyxharit të dinamitit nuk ipej më për "disidentët".

Pasternaku e Solzhenicini ishin bërë recidivistë civilë.

Prandaj tyxhari NATO duhet ta dijë tokën e kujt po e blen.

* * *

Me cilin çmim do ta blejë NATO ishullin e quajtur Shqipëri?

Si do ta blejë Eurounioni kodin civil e biologjik të Prototipit Ibrahim të ishullit Shqipëri?

Eurounioni duhet ta testojë çmimin e Prototipit të pare të pergamenës së Shqipërisë zyrtare.

Të mos e përserisë gabimin e Austrisë së vitit 1912.

As të mos e provokojë.

Ç'do të thotë kjo, të mos e provokojë?

Të mos e provokojë do të thotë të mos e nxjerrë Prototipin jashtë mitrës së familjes biologjike.

A është i detyruar Eurounioni të tregohet kaq i kujdesshëm ndaj Prototipit të Shqipërisë zyrtare.

Po!

Ben Blushi, për herë të parë, Eurounionit ia ofron Prototipin e ndërtuar shkencërisht sipas Formulës [P= Nt + 1t – 1t].

Ç'do të thotë të ndërtosh shkencërisht?

Të ndërtosh shkencërisht do të thotë ta rrokësh udhën biogjenetike e civile.

Ta rrokësh kodin gjenetik.

Ta rrokësh vetë njeriun.

Eurounioni kërkon formulë shkencore për ta pranue Shqipërinë zyrtare.

Sot shqipëriasi i të gjitha llojeve, sipas Formulës së bankrotuar, përpiqet ta trafikojë për pikë të ditës Enver Hoxhën.

E ku ta trafikojë ?

Në "Vilajetin e budallëkut " !

Ku?

Në Kosovë!

Natën e njëqindvjetorit të lindjes së Enver Hoxhës, njëfarë Blendi Fevziu, nëpërmes kamerave të Tv "Klanit" e bëri një "sondazh" sa të mjerë poaq ogurzi.

Sipas SMS-ve të "lexuara" nga kyfarë Blendi Fevziu doli se të gjithë shqipëriasit, me micë e me kucë, janë antienveristë.

Doli se shqipëriasit, me micë e me kucë, qenkan "disidentë".

Sa lajm i mirë për "kurvën" e trishtë Europë!

Por!

SMS-të e këtijfarë Blendi Fevziut e zbuluan atë tjetrën!

E zbuluan se kosovarët, me micë e me kucë, qenkan enveristë!

Doli sikur Enver Hoxha të kishte qenë kosovar.

Doli sikur kosovari, Enver Hoxha, ta kishte pushtua Shqipërinë politike.

Lëkura metalike e Enver Hoxhës, e ambalazhuar, për pikë të ditës u trafikua në Kosovë.

Shqipëriasit shpresuan se lëkura metalike e Enver Hoxhës e përzier me lëkurën metalikë të Skënderbeut do të shitej mirë në Kosovë.

"Kosovarët janë patriotë të zhuritur"- menduan shqipëriasit.

"Do t'i blejnë të dy lëkurat"- menduan shqipëriasit.

E të ngritet zotëria i tij Sami Repishti nga Nju Jorku. Me be e rrfe i lutë kosovarët të mos i bëjnë vend Enver Hoxhës. I lutë kosovarët të mos e blejnë lëkurën e Enver Hoxhës!

Cinizëm i llojit të vet !

Edhe kyfarë Blendi Fevziu i [Tv] "Klanit" të Tiranës edhe ky Sami Repishti i Nju Jorkut edhe shqipëriasit, me gjenin e tyre prej trafikantësh, nëpërmes formulës së bankrotuar [P= + 1t – 1t – Nt], e kontrabandojnë Enver Hoxhën në Kosovë.

Shqipëriasit e Fevziut e të Repishtit, me gjene prej trafikantësh, e lektisin të pamundurën. Donë ta shesin Enver Hoxhën në Kosovë sipas pazarit absurd të Formulës së bankrotuar:

[+ 1t] do të thotë: kosovarët e blenë Enver Hoxhën. U bënë me Enver.

[- 1t] do të thotë: shqipëriasit e shitën Enver Hoxhën. Mbeten pa Enver.

[- Nt] do të thotë: në këtë pazar absurd mungoi vetëm Enver Hoxha.

Vërtet në këtë pazar as nuk u shit gjë as nuk u ble gjë.

Edhe kosovarët, sipas Formulës së bankrotuar, lektisin ta trafikojnë mallin e tyre në pazarin e Shqipërisë politike.

Po cili është ky mall i kosovarëve për t'u trafikuar në pazaret e Shqipërisë politike?

Është patriotizmi kosovar i të burgosurve politikë.

Krejt sipas Formulës së bankrotuar të patriotizmit, kosovarët e blenë Skënderbeun nga Shqipëria politike.

Pasi e vendosën skënderbeun në qendër të Prishtinës kosovarët u zgënjyen.

Shumë u zhgënjyen!

E zbuluan se Skënderbeu nuk kishte koqe!

Skënderbeu ishte i tredhur!

E zbuluan se Skënderbeu nuk kishte flamur!

Këtij pazari i thonë: "Dushk për gogla".

Pas këtij pazari shqipëriasit "disidentë", "viktima", të "virgjër", i drejtohen Eurounionit:

"Ne e hoqëm Enverin. Ne kurrë nuk e donim Enverin.

Ja!

Kosovarët e donë Enverin.

Tash na lejoni të kullosim në livadhet Tuaja të buta!

I kemi merituar livadhet Tuaja të buta".

Konstatim tepër cinik!

Pas këtij pazari absurd, kosovarët trima e patriotë i drejtohen Eurounionit:

"Na pranoni në Eurounion! Përndryshe ne do t'ja çesim ujin e zi Ballkanit"!

Kërcnim se jo mahi!

Konstatim tepër cinik!

Për këtë konstatime kaq cinike, thënë ironikisht, të "dhimbset" Enver Hoxha, të "dhimbsen" shqipëriasit kaq llaskucë, të dhimbset vetë Shqipëria pse shtetasit e vet ia thithin gjinjtë kaq llaskucërisht.

Secili shqipërias "disident", individualisht e mund Diktatorin Enver Hoxha !

E mashtron Enver Hoxhën !

E manipulon !

E trafikon Enver Hoxhën në "Vilajetin e budallëkut" – atje në Kosovë!

Konstatim tepër cinik për të gjitha kohërat !

* * *

Në Kosovë, nën trysninë hardalle të folklorit, ndodh hataja.

I burgosuri politik, në betejë singulare prej kreshnikësh mesjetarë, e mund Jugosllavinë.

A nuk ju duket mjaft për një burrë?!

A nuk ju duket mjaft për një kalorësi kreshnikësh mesjetarë.

Në dialogjet e improvizuara nëpër burgjet jugosllave, me një imagjinatë debile deri në dhembshuri, midis hetuesit udbash dhe të burgosurit politik kosovar, ndodh hataja.

I burgosuri politik kosovar, me argumente historike, e "mbështet" për muri hetuesin udbash.

Hetuesi udbash "dorëzohet" para heroizmes, para qëndresës së të burgosurit politik kosovar.

Lexuesit të kësaj literature të verdhë më shumë i "dhimbset" udbashi se vetë i burgosuri .

Po si të mos i "dhimbset" udbashi serb kur merr pozicin aq fatkeq, aq inferior, aq të mjerë, kundruall të burgosurit politik.

Ky i burgosur politik, me këtë heroizëm debil mëton të bëhët homopolitikus.

Mëton të bëhet pushtetar.

Ish i burgosuri politik kosovar, me mburrje psikogjene, i deklaron Eurounionit:

”Unë e munda Sërbinë e Millosheviqit.
Unë e meritoj livadhin e butë të Eurounionit!”
Konstatim tepër cinik për të gjitha kohërat!
Ish i burgosuri politik kosovar e promovon vetjen përmes Formulës së bankrotuar.
Vetëm kjo formulë i premton:
[+ 1t] i burgosuri politik kosovar e mund Serbinë.
[- 1t] udbashi serb e humb luftën.
[- Nt] të gjithë kosovarët përjashtohen, bëhen të paqenë.
Në këtë Formulë tri herë mungon njeriu.
Përmes kësaj formule i burgosuri politik kosovar e denoncon vetjen e vet.
Konstatim cinik për të gjitha kohërat
Kjo torzo hardalle prej ”disidenti” të Shqipërisë zyrtare apo prej “kreshniku” kosovar mbetet veçse formulë e bankrotuar.
Kjo formulë e bankrotuar e pamundëson integrimin brenda Eurounionit.
Logjika pragmatiste Eurounionin e shpie të mos investojë kot në shtetas të dështuar, në humbës të përhershëm, në formulë të bankrotuar.
Tyxhari eurounionas do të investojë në shtetas vegjetues, të gjallë, të elaborueshëm, të integrueshëm. Të gjitha elaborimet psikofizike e politike i shqyrton me kosto të lartë.
Ky tyxhar nuk blen toka.
Po çka zbuloi Eurounioni në Kosovë?
E zbuloi Prototipin e përtacisë biologjike.
Ç’do të thotë prototip i përtacisë biologjike?
Prototipi darvinian i përtacisë biologjike, i zbuluar në Kosovë, e zbulon evoluimin e llojit sipas Formulës [P= Nt + 1t – 1t].
Atë çka e thotë Ben Blushi teorikisht për Prototipin Ibrahim, në librin “Të jetosh në ishull”, Eurounioni e zbulon praktikisht në Kosovë.
Shqipëria e përmasave të sotme gjeopolitike qysh nga Marin Barleti e deri në vitin 1912 po i bjerrte vlerat e kodit.
Pas këtij viti Shqipëria pushoi së pasuri kod.
Austria e vitit 1912 e theu korracën e mbrojtëse biologjike të Shqipërisë.
E bëri të mvehtësishme pa i ofrue kurrfarë mbrojtjeje shëndetësore.
Shqipërinë e vitit 1913 e rrokën halucinacionet, amoket, vitet e Cometës.
Shqipëria e humbi imunitetin biologjik, e humbi kodin. U bë Shqipëri me HIV.
Ra brenda Formulës së bankrotuar [P= + 1t – 1t – Nt].
Me shtetet tjera ballkanike ndodhi paksa ndryshe.
Ato i bëri të mvehtësishme Rusia por edhe i mekoi me lugë e me pushkë.

I vetmi ishull në Ballkan, i mbrojtur me korracë biologjike, mbase edhe në Europë, mbeti Kosova.

Kosova e pushtuar qe e detyruar të mbrohet me korracën e vet biologjike deri në vitin 1999 brenda Formulës [P= Nt + 1t – 1t].

Vetëm brenda kësaj formule ruhet kodi gjenetik.

Pas vitit 1999 në qiellin kosovar, atykëtu zu të shfaqet Cometa e formulës së bankrotuar.

Shtetarët kosovarë filluan të bëjnë politikë sipas njësive të Formulës së korruptuar.

Vetëm kjo formulë, në shtetet e dyshimta politikisht, ua siguron pushtetin shtetarëve.

Formula e korruptuar shtetarëve ua mundëson kontrabandimet më të paskrupullta duke i çpifur tiparet.

Kjo formulë i mundëson shtetarit t'ia çpifë vetjes tiparët më pozitive e kundërshtarit t'ia çpifë tiparet më negative.

Sipas Formulës së bankrotuar shtetari mund t'i akuzojë të gjithë shtetasit. Mund t'i gjykojë të gjithë shtetasit. Mund t'i ekzekutojë të gjithë shtetasit.

Po ta zbërthejmë Formulën e bankrotuar do të fliste:

[+ 1t] është shtetari,

[- 1t] është shtetasi

[- Nt] është njeriu

Po a është shtetari njeri?

Jo!Nuk është shtetari njeri.

Po a është shtetasi njeri ?

Jo! Nuk është shtetasi njeri.

Po atëherë cili është njeriu?

Njeriu mungon në Formulën e bankrotuar.

Në shtetet e Formulës së bankrotuar ka vetëm ngadhënjimtar e të mundur, gjykues e të gjykuar, dënues e të dënuar, ekzekutues e të ekzekutuar.

Mungon vetëm njeriu.

Përderisa popujt nuk bëhen shtete të pavarura Formula e bankrotuar nuk mund ta promovojë vetjen e saj.

Mund të thuhet së në Kosovë nuk ka mundur ta shtrijë pushtetin e vet Formula e bankrotuar. Kosovarët gjithmonë kanë qenë nën sundimin e huaj. U është dashur të barrikadohen brenda korracës biologjike – brenda përtacisë biologjike.

Deshen apo nuk deshen, kosovarët qenë të detyruar ta ruajnë kohezionin e kodit biologjik brenda barikadimit biologjik – brenda familjes biologjike.

Nëse Ben Blushi, jo kot, shpurdh në gjysmën e parë të shekullit XVIII për ta gjetë Prototipin Ibrahim, Euroamerika këtë lloj Prototipi e gjen, me bollëk, në Kosovën e vitit 1999.

Euroamerika në Kosovë e zbuloi El Doradon e Kodit biologjk.

Kjo Bretkosë kosovare e Darvinit i jep të gjitha informatat e evolucionit të shndërruar në revolucion. I zbulon të gjitha nyjëtimet e gabimeve gjenetike.

Natyrisht se do të emërtohet si Bretkosë arketipe.

Bretkosa kosovare e Darvinit e zbulon se revolucioni ndodh vetëm brenda formulës së bankrotuar[P = + 1t – lt – Nt].

Bretkosa kosovare e Darvinit e zbulon se revolucioni është shajni kolektive – pa njeri brenda.

Zbulon se lëkura e Enver Hoxhës, edhe pse me çmim kinez, edhe pse e trafikuar tok me lëkuren e Skënderbeut të Prishtinës, nuk mund të shitet në "Vilajetin e budallëkut" – Kosovë.

Prototipi i Darvinit kosovar do ta resht brengës atë Blendi Fevziun e "Klanit" shqipërias se Enver Hoxha do të bëhet kosovar. Do ta resht brengës "megadisidentin" shkodran, Sami Repishtin, se Bretkosa e Darvinit kosovar e ka harruar Tivarin e vitit 1945 nëpër midis të Shkodrës e, tivarëve të tjerë.

Prototipi i Darvinit kosovar ka pretendime shumë më të larta se të blejë lëkura të dalura afatit.

Prototipi i Darvinit kosovar han fre të shtrojë bisedë me Euroamerikën e me Izraelin vetëm brenda Formulës[P = Nt + 1t – 1t].

Për çka do të bisedohet?

Prototipi i Darvinit kosovar do bisedojë për menstruacionet politike të Europës së shekullit XX. Do të bisedojë për shtatëmbëdhjetë minutat e orgazmës politike të Europës.

Do të bisedojë me Amerikën për natën e njëzetegjashtë të Janarit të vitit 1621 kur John Harkeri u ngop me tri lloje qumështash jashtëbiblikë.

Po me Izraelin çka do të bisedojë Bretkosa e Darvinit kosovar?

Do të bisedojë për natën e tretë të shtatorit të vitit 70 të Jerusalemit.

Këtë natë rabinët e Jerusalemit përmes "Hosana Barabas" vendosën të hyjnë në Formulën e bankrotuar [P= + 1t – 1t – Nt].

Kjo do të thoshte të hysh në luftë të pabarabartë kundër Romës.

Kjo do të thoshte vdekje e sigurtë e Izraelit.

Rektori i të dy universiteteve të Izraelit, rabi Jochanan ben Sakai, e kundërshtoi Formulën e bankrotuar të rabinëve të Tribalit të madh.

Rabinët e shpallen tradhtar rabi ben Sakain.

Po atë natë, rabi Jochanan ben Sakai vendosi të arratiset. Tok me tridhjetë studentët e vet të ngarkuar me librat e Izraelit u nis drejt diasporës.

Të nesërmen, deri në mesditë, Jerusalemi u bë rrafsh me tokë. U vranë të njëmilionë banorët e Jerusalemit. U bënë shkrumb e hi të dy bibliotekat.

Rabi Jochanan ben Sakai e ruajti, e shpëtoi kodin hebre gjithandej diasporës.

Pas l878 vjetësh rabi Jochanan ben Sakai u kthye me aeroplanë reaktivë euroamerikanë për ta ribërë Izraelin e vitit 1948.

Krejt çka do të bisedojë Bretkosa kosovare e përtacisë biologjike të Darvinit me Eurounionin, me Amerikën e John Harkerit dhe me Izraelin, u shpallen në librin me titull "Pocahontas Powhatan" i financuar nga ABF- në Treleborg të Suedisë.

Bretkosa e Darvinit kosovar do t'i tregojë Eurounionit se Kosovës, edhe pse me pretendime në trashëgiminë dardane, i mungoi një rabi me koqe për ta shpëtuar kodin e saj. Do t'i tregojë se Kosova e pushtuar gjatë gjithë diakronisë e ruajti kodin brenda korracës biologjike. Mbijetoi në gjendjen e arketipit biologjik.

Lulet vetëm kur çelin mund t'i vrasë acari.

Bretkosa e Darvinit kosovar do t'i tregojë Unionit euroamerikan se kodi i Kosovës rrezikohet vetëm pas Ditës së shtatëmbëdhjetë të shkurtit të vitit 2008. Po qe se Unioni euroamerikan e pushon kujdesjen akusherike obstetrike mbi Kosovën e passhtatëmbëdhjetë shkurtit të vitit 2008 kodi i Kosovës do të prishet. Unioni euroamerikan do ta përseriste pikëpërpikë gabimin e Austrisë së vitit 1912 me kodin e Shqipërisë politike.

Bretkosa e Darvinit kosovar Unionit euroamerikan do t'ia jep informatën e saktë të kodit brenda Formulës [P = Nt + 1t – 1t] duke filluar nga qeliza, indi, organi, organizmi e, deri tek prototipi.

Në këto pllakëza informative është ruajtur, brenda korracës biologjike, kodi i Kosovës ndryshe nga ç'është ruajtur kodi i Izraelit.

Qysh larg në diakroni Dhimitër Shuteriqi e ndjen jehun e kumtit të qashtër se Shqipërisë politikë i mungojnë të dy llojet e kodit. I mungon kodi i civilizimit të lartë të tipit të Izraelit, në njërën anë dhe kodi biologjik i Bretkosës së Darvinit kosovar në anën tjetër. Andaj vendosi të flasë ndryshe, krejt ndryshe përmes "Të jetosh në ishull" të Ben Blushit. E zgjodh rrugën e tretë.

Le të bëjmë pak histori.

Le ta krahasojmë për një çast Shkodrën e Marin Barletit më Jerusalemin e rabi Jochanan ben Sakait.

Ditën e tretë të marsit të vitit 1479 Marin Barleti u arratis nga Shkodra. Me vete nuk e mori asnjë libër. Historianët tekajytë ia mveshin se në Shkodër paskësh pasur libra të shkruara në gjuhën e Marin Barletit.

Sikur Marin Barleti ta kishte shpëtuar vetëm një libër të gjuhës së vet atëherë shqipëriasit nuk do ta fillonin historinë e shkrimit nga ajo Formula aq e dyshimtë e pagëzimit.

Meqë Marin Barleti nuk e shpëtoi kodin e civilizimit iliroarbresh atëherë Ben Blushi i Dhimitër Shuteriqit, përmes librit "Të jetosh në ishull"e shpëtoi kodin biologjik, e shpëtoi rrugën e evolucionit biologjik shqipërias deri në gjysmën e parë të shekullit XVIII, deri tek Prototipi i tij Ibrahim.

Ben Blushi i Dhimitër Shuteriqit e pikasi se nuk mund t'i dilet përpara Unionit euroamerikan me Formulën e bankrotuar të Marin Barletit [P= + 1t – 1t – Nt]. Kjo formulë kaq joshëse për shqipëriasit nuk të shpie tek kodi as që ka kod brenda vetjes.

Midis dy hebrenjve, midis rabi Jochanan ben Sakait dhe Sabatai Sevit, Formula e bankrotuar i përket Sabatai Sevit.

Një herë një hebre, i quajtur Sabatai Sevi, ua lypi shqipëriasve një copë tokë sa për një varr. Shqipëriasit e trafikuan Sabatai Sevin në dy varre, në Berat dhe në Ulqin.

Sabatai Sevit i tepruan varret.

Shqipëriasit kanë provuar ta trafikojnë Sabatai Sevin edhe në Izrael.

Nuk u bë!

Beratasit dhe ulqinakët u hëngrën në pazar.

Në Formulën e bankrotuar të Shqipërisë salihe nuk ka as kod as varr.

Në Shqipërinë politike trafikohen të gjitha: historia, zoti, profeti, tempulli, religjioni, atdheu, libri, gjuha.

Të gjitha mund t'i gjesh në pazaret e arxhinjve, gjithandej Laprakës me çmime kineze.

Sot kur Shqipëria politike ka hipërinflacion me "Made in Albania", të quajtur Enver Hoxha, provon ta gjejë një pazar, jashtë shtetit, për ta shitur këtë mall.

Po ku ta shesë tjetër përveçse në "Vilajetin e budallëkut" – në Kosovë?!

Pasi cincarët shqipërias e amballazhojnë mallin e tyre në stilin e reklamës "katër me lekë e një falas", e trafikojnë në "Vilajetin e budallëkut" – në Kosovë.

Katër lekë kushton Enver Hoxha e falas shkon Skënderbeu.

Malli "Made in Albania", i trafikuar në "Vilajetin e budallëkut", kosovarëve u doli me defekte. Skënderbeu dhe Enver Hoxha nuk paskëshin pasur koqe!

Bretkosa e Darvinit kosovar u zhgënjye. Deshi ta kthejë mbrapa kontingjentin "Made in Albania".

Trafikantët shqipërias, pasi e "pastruan" Shqipërinë e tyre nga zdërvajat e Enver Hoxhës, të veshur me kostume alla evropiane, nën maskat e

“disidencës”, i vërshuan pazaret e Eurounionit. Shqipërinë politike, të “pastruar” nga zdërvajat e Enver Hoxhës, të ambalazhuar me etiketën standarde “Made in Albania”, cicarët shqipërias e trafikuan në pazarin e Brukselit.

Tyxhari Eurounion, si gjithmonë, e vështroi vëngër mallin e trafikuar Made in Albania. Tyxhari Eurounion e njihte shumë mirë këtë mall Made in Albania, të trafikuar aq herë nga Enver Hoxha nëpër pazarët euroaziatike të Jugosllavisë, Rusisë, Kinës, Vietnamit, Kamboxhës e, deri tek qymezët e vogla amerikolatine të Fidel Kastros. Tyxhari Eurounion e njihte Formulën e bankrotuar [P = + 1t – 1t – Nt] të shteteve ballkanase.

Tyxhari “Jenki” i NATO-s foli ndryshe. Ai bëri Pazar me cincarët shqipërias, njësoj siç bëri me të gjitha shtetet ishsocialiste të paktit të Varshavës. Ky tyxhari “Jenki” i NATO-s e bleu djerrinën Shqipëri pa u interesuar aspak për kualitetin e kodit civil e biologjik të shqipëriasve.

Këtij tyxharit “Jenki” të NATO-s i duhet vetëm globalizmi gjeometrik. I duhen vetëm tokat djerrina të ishshteteve socialiste të paktit të Varshavës që këto toka të mos bëhen edhe një herë lëkurë djalli për kultivimin e ekspansionizmit rus, të falsifikimit socekonomik e biosocial kinez apo të fundamentalizmit panmysliman.

Tyxhari “Jenki” i NATO-s ia la Eurounionit përkujdesjen klinike për ribërjen e kodit civil e biologjik të shtetasve të djerrinave ishsocialiste.

Shtetari hardall i Shqipërisë politike çjerrët deri në kupë të qiellit se djerrina Shqipëri po pranohet në paktin NATO. Ulurimën e Salihut të vet shtetasi cincar i Shqipërisë politike e kupton mbrapsht. E kupton se të hysh në NATO do të thotë të hashë qull falas në kazanin e Eurounionit, të kullosësh falas në livadhet e buta të Eurounionit, t’i tarahitesh koqet nëpër “bordelet” e Eurounionit.

Tyxhari Eurounion bën tjetër pazar me Shqipërinë politike nga ç’bëri tyxhari”Jenki” i NATO-s.

Tyxharit Eurounion i duhet kodi i kualitetit civil e biologjik të shtetasit të Shqipërisë politike.

Po a do ta gjejë tyxhari Eurounion kodin kualitativ civil e biologjik të shtetasit shqipërias?

Jo! Asgjëkundi!

Atëherë në pazarin e Eurounionit u paraqit Ben Blushi me Prototipin kualitativ të kodit biologjik. Ekzemplari i kodit kualitativ të Blushit është i vjetër në moshë për dy shekuj. Fletëgarancioni i këtij ekzemplari del tepër i sakt për përdorim nga Eurounioni. Në fletëgarancionin e Prototipit të Blushit ipet Formula e përdorimit [P = Nt + 1t – 1t].

Sipas kësaj formule Darvinit të Eeurounionit iu desht paksa punë. Iu desht të ngjitet për dy shekuj në diakroninë e gjenetikës shqiptare, deri te prototipi Ibrahim i Ben Blushit – sipas librit "Të jetosh në ishull". Për ta zbuluar zanafillën e stërkeqjes së kodit gjenetik të shqipëriasve Darvini i Eurounionit u desh ta kapë Bretkosën shqiptare të shekullit XVIII.

Në tavolinën e Darvinit Bretkosa shqiptare i jep të gjitha informatat e kodit gjenetik të llojit të vet.

Cila informatë do të jetë aq e saktë sa të shndërrohet në Formulë?

Formula [P= Nt + 1t – 1t] thotë : "Kur shqiptari nxirret jashtë familjes biologjike vdes".

Ç'do të thotë kjo "Vdes"?

Do të thotë krejt!

Do të thotë e bjerrë kodin.

Shqipëriasi kur del jashtë familjes biologjike përballet me zotin e huaj, me profetin e huaj, me fenë e huaj, me tempullin e huaj, me gjuhën e huaj, me librin e huaj, me ideologjinë e huaj.

Shqipëriasi nuk di të bëjë pazar. Nuk di as të blejë as të shesë. I mungojnë njësitë matëse. Sa herë ka hy në pazar me zotin e huaj, me profetin e huaj, me tempullin e huaj, me fenë e huaj, me librin e huaj, shqipëriasi e ka shitur vetjen e vet me çmim kinez.

Me këto njësi matëse shqipëriasi i sotëm "mendon" të bëjë pazar me tyxharët e Eurounionit.

Si përherë shqipëriasi gabon.

Darvini i Eurounionit, sipas sugjerimit të librit "Të jetosh në ishull" të Ben Blushit të Dhimitër Shuteriqit, në Kënëtën shqiptare e kapë Bretkosën e kodit biologjik vetëm dy shekuj më heret.

Kjo Bretkosë kushton shtrenjtë sepse i jep të gjitha informatat e llojit të vet.

Kjo Bretkosë prototipe e Ben Blushit, me emrin e përkohëshëm Ibrahim, e provokon pazarin midis Eurounionit, në njërën anë, e salihëve e të të gjithë hamajve të lamës politike të quajtur Shqipëri, në anën tjetër.

Kaq shumë mund të bëjë një libër?!

Po! Kaq shumë!

Kaq shumë mund të bëjë një Bretkosë prototipe e Darvinit?!

Po!Kaq shumë!

Për herë të parë në Pergamenën e Shqipërisë politike, në librin e Ben Blushit të Dhimitër Shuteriqit, promovohet Njeriu i Formulës [P= Nt + 1t – 1t].

Për herë të parë Ibrahimi i kësaj Formule blen emër për vete, blen zot për vete, blen profet për vete , blen tempull për vete, blen religjion për vete, aqsa i duhet për konsum në familjen e vet biologjike.

Kjo do të thotë të bësh pazar duke e matur saktësisht sasinë dhe cilësinë e mallit të blerë.

Në librinpergamenë të Ben Blushit "Të jetosh në ishull" Skënderbeu, Avdyl Frashëri, Ismail Qemali, Fan Noli, Ahmet Zogu, Enver Hoxha, e i gjithë ollumi i Shqipërisë së sotme, bëjnë pazar me Europën sipas Formulës së bankrotuar [P = + 1t – 1t – Nt].

Të gjithë këta pazarxhinj të diakronisë së Shqipërisë politike, me çmime kineze, shiten te zoti i huaj, te profeti i huaj, te tempulli i huaj, te feja e huaj, te libri i huaj.

Të gjithë këta pazarxhinj, me çmime kineze, blejnë varre për vete jashtë Shqipërisë politike, kudo gjithandej Europës e Amerikës.

Të gjithë shqipëriasit e sotëm, të vetëshpallur "disidentë", me çmime kineze, krejt sipas Formulës së bankrotuar, blejnë varre për vete në fund të detit të huaj, në fund të tokës së huaj, në fund të shtetit të huaj.

Mbi varrin e "disidentit" shqipërias tek varrezat e Moskës shkruan: "Nitkov."

Mbi varrin e "disidentit" shqipërias tek varrezat e Stambollit shkruan: "Estokf'llah!"

Mbi varrin e "disidentit" shqipërias" te varrezat e Vjenës shkruan:"Volf"

Shkruan:

"Këtyre varreve u ka tepruar zoti, u ka tepruar profeti, u ka tepruar tempulli, u ka tepruar feja"!

Atëherë!

Kush nga shqipëriasit do të bëjë pazar me Eurounionin?

As më pak as më shumë:

Me Eurounionin do te bëjë pazar vetëm Ibrahimi i "Ishullit" të Ben Blushit. Vetëm ky Prototip, nga brenda Familjes biologjike, i ka të gjitha njësitë matëse të Formulës së liçencuar zyrtarisht nga Eurounioni [P = Nt + 1t – 1t].

Kjo liçencë zyrtare e Ibrahimit të Ben Blushit u regjistrua në Bruksel tek skedari me shënimin:

"Liçenca e Kodit biologjik të Shqipërisë".

* * *

Po varrit të hebrenjve a i ka teprua zoti, a i ka teprua profeti, a i ka teprua tempulli, a i ka teprua feja, a i ka teprua atdheu?

Varrit të Hebreut "Hosana Baraba" i kanë tepruar të gjitha.

Po nga hebrejt e Izraelit kush e bëri pazarin e vitit 1948 me Unionin euroamerikan?

Pazarin e bëri rabi Jochanan ben Sakai - rektori i të dy universiteteve hebreje.

Sipas cilës formulë bëri pazar me Unionin euroamerikan rabi ben Sakai?

Sipas Formulës [P = Nt + 1t – 1t]. Vetëm ky hebre e kishte liçencën e Formulës profitabile.

A kishte Izraeli Formulë të bankrotuar[P= + 1t – 1t – Nt] ?

Po! Kishte!

A u përdor ndonjëherë Formula e bankrotuar për të bërë kontrata ndërshtetërore?

Po! U përdor! Në vitin 70 të Jezusit rabinët e Tribalit të madh të Izraelit e përdorën për t'i rënë ndesh perandorisë së Romës.

A funksionoi Formula e bankrotuar hebreje?

Jo! Të nesërmen imperia e Romës e bëri rrafsh me tokë Izraelin. Një dite më vonë Jerusalemi nuk ekzistoi. U vranë të gjithë banorët. U dogjën të dy bibliotekat.

Atëherë hebrenjtë e paskan djegë Kodin e vet biologjik në vitin 70 të jezusit?!

Jo! Rabi Jochanan ben Sakai, tok me 30 nxënësit e vet të Sanhredinit, të ngarkuar në shpindë me librat e të dy bibliotekave të Jerusalemit, natën e tretë të shtatorit të vitit 70 të Jezusit, u arratis nga Jerusalemi drejt diasporës europiane. Rabi ben Sakai e shpëtoi zotin e Izraelit, profetin e Izraelit, tempullin e Izraelit, fenë e Izraelit, librin e Izraelit. E shpëtoi Kodin e Izraelit. E shpëtoi Formulën profitabile të Izraelit [P= Nt + 1t – 1t]. Është i vetmi hebre i liçencuar zyrtarisht për të kontraktur me Unionin euroamerikan.

* * *

Po pse në diakroninë shqiptare nuk u gjend një burrë i kalibrit të Rabinit ben Sakai?

Skënderbeut, Marin Barletit, Pjetër Bogdanit, Avdyl Frashërit, Ismail Qemalit, Fan Nolit, Ahmet Zogut, Enver Hoxhës, edhe këtyre të sotmëve, u mungojnë koqet. U mungoi zoti me koqe, profeti me koqe, tempulli me koqe, religjioni me koqe, libri me koqe. Sot të gjithë këta eunukë shiten me çmime kineze, të vjerrur nëpër çengelat e kasapëve të Laprakës. Në skenat "portokalli" të humorit të Laprakës, të gjithë shtetarët, prej atij Skënderbeut e deri tek Sali Berisha bëjnë striptiz para spektatorëve të dyshimtë. Të gjithë këta burrështetas, prej atijfarë Skënderbeut e deri tek Salihu, në skenën "Portkalli" të Agron Llakajt dalin burrështetas pa koqe. Sa vështirë për publikun e dyshimt të shohë striptiz eunukësh! Skena Portokalli e Agron Llakajt shkon përtej ogurit të humorit debil për spektatorët e dyshimtë. Skena Portokalli e Agron Llakajt pretendon të bëhet tezgë, apo thënë me gjuhë paksa më evropiane, të bëhet "çento vitrine" e prodhimit "Made in Albania" të Laprakës. Në skenën e tij Portokalli të Laprakës Agron Llakaj të gjithë i nxjerrë për pazar me çmime kineze prej Skënderbeut e deri te Salihu – edhe publikun e tij të dyshimtë, edhe vetjen e tij i nxjerr në pazar me etiketën "Made in Albania". Prodhimet e veta të Laprakës Portokalli Agron Llakaj mendon t'i shesë në pazarin e Brukselit. Nëpërmes humorit të striptizerëve eunukë të Laprakës Agron Llakaj mendon ta trafikojë në pazarin e Brukselit porosinë prej Pilati se Shqipëria është pastruar jo vetëm nga Enver Hoxha por nga të gjitha figurat e historisë shqiptare. Andaj spektatorët portokallinj të Agron Llakajt e meritojne qullin e kazanit të Brukselit, e meritojnë t'i tarahisin koqet nëpër livadhet e buta të Eurounionit. Të gjithë spektatorët e dyshimtë të tezgës Portokalli, Agron Llakaj i "zbavitë" duke i bërë "Hosana". Por Agron Llakaj, nëpërmës tezgës Portokalli, po e denoncon spektatorin e tij "Hosana" duke e nxjerrë në pazarin e Bruksalit më çmim kinez sipas Formulës së bankrotuar [P = + 1t – 1t – Nt].

Formula zbulon se i vetmi shqipërias me koqe, i licencuar për të negociuar me Eurounionin shpallet Ibrahimi i Ben Blushit i librit "Të jetosh në ishull".

Po Kosovari a ka varr?

Po! Kosovari, Redalk san Heldiku, i ka tri varre në tri perandori. Testiset ia kanë varrosur, natën e dytë të prillit 1999, tek varrezat e Haremit të dytë të sulltanit në Stamboll. Mbi varr, atje në stamboll, i shkruan:

"Estokf'llah"!

Të njejtën natë të prillit, penisin ia kanë varrosur në varrezat e Moskës. Mbi varr, atje në Moskë, i shkruan:

”Nepoznat”!

Po atë natë të prillit, kufoma e tij prej eunuku u varros në varrezat e Vjenës. Mbi varrin e tij, atje në Vjenë, shkruan “Volf”!

Të tri perandoritë u vonuan pasi gjenerali amerikan Vesli Clark e kishte mbëltuar farën e Redalk san Heldikut në mitrën e gruas kosovare. Redalk san Heldiku u lind qershorin e dymbëdhjetë të vitit 1999 sipas standardeve të Formulës profitabile [P= Nt + 1t – 1t].

Është i vetmi kosovar i licencuar zyrtarisht për të bërë pazar me tyxharin e Eurounionit.

Sipas librit “Pocahontas Powhatan” të financuar nga ABF-i në Treleborg - Suedi, kosovari, Redalk san Heldiku, është njohur me Rabi ben Sakain qysh atje te shkretëtira e Negevit. Atë natë Rabi e urdhëroi kosovarin, Redalk san Heldikun, të hyjë në tendën e Zatres Arameje. Kosovari, san Heldik, e zbatoi urdhrin e Rabis. Në shkulmin e epshit gratë e seksit iu përzien. Nuk dalloi cila qe Zatra e cila qe Sofia.

Rabi i tha:

“O kosovar! U bë!”

* * *

Pse u desht t’i ipet zyrtarisht licenca e Formulës profitabile [P= Nt + 1t – 1t] Ibrahimit të Blushit? Ibrahimi i Ben Blushit tregon se shqipëriasit kur dalin jashtë familjes biologjike bëhen trafikantë, kontrabandistë, spekulantë, matrapazë. Vetëm liçenca zyrtare e Formulës profitabile i rregullon standardet e pazareve midis Shqipërisë politike dhe Kosovës. I rregullon standardet e pazareve midis Shqipërisë zyrtare dhe Eurounionit.

Vetëm Ibrahimi i Ben Blushit, në tërë Shqipërinë politike, e ka liçencën e njësive matëse për peshat dhe cilësitë e mallit të bagazhuar për këto pazare sipas Formulës së kodit civil e kodit biologjik [P = Nt + 1t – 1t].

Sot, e gjithë natën e lume të zotit, “disidentët” e Shqipërisë politike dhe “disidentët” e burgosur politikë të Kosovës bëjnë pazare të ndërsjella trafikantësh sipas Formulës së bankrotuar[P= + 1t – 1t – Nt]. Skënderbeun dhe Enver Hoxhën i blejnë matrapazët shqipërias me çmime kineze, ashtu copa-copa, nga çengelat e kasapëve të Laprakës. Të ambalazhuar përngutshëm, me një shkrim prej matrapazësh “Made in Albania”, malli trafikohet në Kosovë më çmim të fryer.

Malli i trafikuar u dual çyryk kosovarëve. U duel me defekte gjenetike. Skënderbeu dhe Enver Hoxha nuk kishin koqe.

Shteti shqiptar, me një maskë keqardhjeje në fytyrë për kosovarët e mashtruar, përpiqet të trafikojë "disidencë" Made in Albania në pazaret e Eurounionit. Shteti shqiptar, me maskën e tyxharit në fytyrë, provon ta bindë Eurounionin se shtetasit e Shqipërisë politike qe prej fillimit e kanë urrejtur Enver Hoxhën, se e kanë mashtruar Enver Hoxhën, se e kanë vënë në lojë. Si nën hundë shqipëriasit i thonë Eurounionit se janë kosovarët ata që e donë Enver Hoxhën.

Shteti shqiptar, krejt ndërkyeshëm, sipas parametrave të Formulës së bankrotuar [P = + 1t – 1t – Nt], mashtrohet se do të trafikojë "disidencë" në pazaret e Eurounionit ashtu siç po trafikon mall çyryk në Kosovë.

Pazari i Eurounionit dhe pazari i Kosovës ndryshojnë nga njëri – tjetri.

Tyxhari "jenki" i NATO-s dhe tyxhari i Eurounionit ndryshojnë nga njëri – tjetri.

Tyxhari "jenki" i NATO-s është tyxhar tokash.

Me çështje kodesh gjenetike e civile merret Eurounioni.

Cili kosovar ogurzi mundohet të mos besojë se tyxhari "jenki" i NATO-s me 38000 fluturime të 78 netëve bombardimi mbi Sërbinë se nuk e bleu shtrenjtë Kosovën?

Cili i burgosur politik kosovar, aq ogurzi, mundohet të besojë se mund t'i tarahitë koqet nëpër Kosovë duke bërë politikë e duke kontrabanduar mall antiamerikan nga Shqipëria?

Cili salih i Shqipërisë salihe do ta mashtrojë botën se si të hysh në NATO automatikisht do të hashë qull në kazanin e Eurounionit? Se si të hyshë në NATO do t'i tarahitësh koqet nëpër "bordelet" e buta të Eurounionit e të njëjtën kohë duke trafikuar mall antiamerikan në Kosovë.

Cili Millosh i Sërbisë Milloshe mund të mos besojë se lufta i sosë fjalët, i sosë pazaret e Hagës?

Të tri këto shtete ulurojnë për të hyrë në Eurounion duke kontrabanduar mall antiamerikan.

Për të hyrë në Eurounion duhet biseduar me tyxharin e Eurounionit, me vetë Havier Solanën.

Kontrabandistët ballkanas të mallit antiamerikan gabojnë kur mendojnë se edhe njëfarë ishkomunisti i dikurshëm spanjoll, i quajtur Havier Solana, dikur ka bërë pazar me Eurounionin sipas Formulës së bankrotuar [P= + 1t – 1t – Nt] të Dolores Ibarurit.

Për të bërë Pazar me tyxharin Havier të Eurounionit duhet dërguar Njeriun e liçencuar sipas standardeve te Formulës profitabile [P= Nt + 1t – 1t].

Njeriu i Shqipërisë politike, i licencuar sipas standardeve të Formulës profitabile për të biseduar me Havierin, shpallet Ibrahimi i "Ishullit" të

Darvinit shqipërias. Ky ekzemplar i Kënetës Shqipëri do të bisedojë me tyxharin Havier të Eurounionit - askush tjetër prej atij Skënderbeut Salih e deri tek salihët e sotëm.

Shqipëria politike e "Time of Comet" do të çjerret sa i çet për kreje:

"Po si mund të nxirret njëriu nga libri e të dërgohet në Bruksel për të biseduar me tyxharin Havier"!?

Formula profitabile [P= Nt + 1t – 1t] e Kodit të licencuar të Shqipërisë ekziston.

Zgjat dorë e merr!

Njëriu i Kosovës, i licencuar sipas standardeve të Formulës profitabile, del Redalk san Heldiku i librit "Pocahontas Powhatan". Ky ekzemplar i Darvinit Kosovar do të bisedojë me tyxharin Havier të Eurounionit – askush tjetër qe nga Isa Boletini i karaxhozllëqeve me pistoleta në Londër e deri te karaxhozët e sotëm të cirkut me pistoleta.

Kosova karaxhoze do të çjerret sa i qet për kreje:

"Po si mund të nxirret njeriu nga libri e të dërgohet në Bruksel për të biseduar me tyxharin Havier!?"

Formula profitabile [P= Nt + 1t – 1t] e Kodit te liçencuar të Kosovës ekziston.

Zgjat dorë e merr!

Hazyr Dervishi
[fragment nga " Libri i formulave "]